

P. P. <sup>time</sup>



## **REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË POGRADE**

Nr. § 77 Prot.(D.B)

Kopje Nr. \_\_\_\_\_  
Pogradec, më 25/02/2021

**Lënda : Dërgohet Raporti Vjetor Mbi Ecurinë e Punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2020**

## Drejtuar : Prokurorit të Përgjithshëm

TIRANË

## I Nderuar Z. Prokuror i Përgjithshëm.

Në vijim të komunikimit me Ju, pasi u njoha me shkresën nr.68 prot datë 14.01.2021, në zbatim të nënit 50 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorise në Republikën e Shqipërisë”, dhe Urdhrit nr.330 datë 29.12.2016 “Për përbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë”, ju dërgojmë Raportin Vjetor mbi Ecurinë e Punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për vitin 2020.

*Duke ju falenderuar pér mirëkuptimin*

## DREJTUESE E PROKURORISË

DORINA BEJKO

## PERMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| <b>I.Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2020 .....</b>   | <b>5</b>  |
| ▪ Respektimi i të drejtave të njeriut .....  | 5         |
| ▪ Të miturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima .....  | 5         |
| ▪ Bashkëpunimi ndërinstitucional.....  | 7         |
| ▪ Bashkëpunimi ndërkombëtar....."  | 9         |
| ▪ Përdorimi i metodave speciale tëhetimit dhe hetimet proaktive.....   | 9         |
| ▪ Informacion mbi zbatimine Udhëzimevetë Prokuroritë Përgjithshëm.....   | 9         |
| ▪ Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020.....  | 11        |
| ▪ Informacion mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020..... | 13        |
| ▪ Problematikat e konstatuara .....  | 16        |
| <br>   |           |
| <b>II.Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës sëprokurorisë .....</b>  | <b>17</b> |
| • Të dhënat përgjithshme tëtreguesvetëhetimit.....   | 17        |
| ○ Kriminalitetit sipas përhapjes së veprave penale.....  | 20        |
| ○ Kriminaliteti sipas shtrirje territoriale.....   | 21        |
| • Volumi i punës në fazën e hetimeve paraprake.....  | 22        |
| • Veprimtaria proceduriale në fazen e hetimit paraprak.....  | 24        |
| ○ Masat e sigurimit personal .....   | 24        |
| ○ Ceshtjet e transferuara.....   | 26        |
| ○ Ceshtjet e pushuara.....   | 27        |
| ○ Cështjet e pezulluara.....   | 28        |
| ○ Ndryshimet e cilësimit ligjor.....   | 29        |
| ○ Zgjatja e afateve hetimore.....  | 29        |
| ○ Pergjegjja penale e personave juridike.....  | 30        |
| ○ Masat mjekësore dhe edukuese.....  | 30        |
| ○ Veprat penale në fudhën e krimite ekonomiko-financiar.....   | 33        |
| ○ Zbatimi i ligjit te dekriminalizimit.....  | 33        |
| ○ Ceshtjet e derguar në gjyq.....  | 34        |
| <br>   |           |
| <b>III. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorëvë gjatë fazës së gjykimit .....</b>   | <b>35</b> |
| ○ Faza e gjykimit të procedimeve penale.....   | 35        |
| ○ Të dhëna për gjykimet e posacme.....   | 36        |
| ○ Të dhëna për pafajsitë, pushimet dhe ankimet.....  | 37        |
| ○ Të dhëna për llojin dhe masat e dënimive.....  | 38        |
| ○ Ankime.....  | 40        |
| ○ Kompesime për burgime të padrejta.....   | 41        |

|   |           |
|---|-----------|
| ○ Të dhëna për të pandehurit dhe viktimat e mitur.....  | 41        |
| <b>IV.Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore.....</b>                                | <b>42</b> |
| <b>V.Të dhëna mbi mardhëniet juridikSIONALE me autoritetet e huaja.....</b>                   | <b>42</b> |
| <b>VI.Të dhëna për ngarkesën e punë për cdo prokuror dhe oficer të poicisë gjyqësore.....</b> | <b>43</b> |
| <b>VII.Informacion mbi administrimin e Prokurorisë.....</b>                                   | <b>45</b> |
| <b>VIII.Drejtimet dhe përparësítë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021.....</b>     | <b>46</b> |

**RAPORTI VJETOR MBI ECURINE E PUNËS**  
**NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS**  
**SË PARË POGRADEC**  
**PËR VITIN 2020**

I Nderuar Zoti Prokuror i Përgjithshëm,

Në zbatim të nëniti 50 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorise në Republikën e Shqipërisë”, dhe Urdhrit nr.330 datë 29.12.2016 “Për përbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë” Ju paraqesim Raportin Vjetor Mbi Ecurinë e Punës në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Nëpërmjet këtij materiali, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, Ju paraqet treguesit e përgjithshëm të veprimtarisë së saj, realizuar gjatë vitit 2020, në ushtrimin e ndjekjes penale, në hetimin e çështjeve penale, përfaqësimin e akuzës para gjykatës, fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.

Metodologjia e këtij raporti, në përputhje edhe me raportet e viteve paraardhëse, konsiston në mbledhjen e të dhënave statistikore të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në sintezën e këtij informacioni dhe analizën e aspekteve të vecanta në veprimtarinë dhe administrimin e Prokurorisë.

Në një vlerësim paraprak, duke marrë në konsideratë të dhënat që do të analizojmë në mënyrë të detajuar në vijim të këtij materiali, elementi i parë që evidentohet është se përgjatë vitit 2020, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ka përballuar një ngarkesë **të përafërt** me atë të vitit paraardhës.

## I.Drejtimet dhe përparësitë në luftën ku ndër kriminalitetit në vitin 2020

### ▪ Respektimi i të drejtave të njeriut

Në kuadër të garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, vlerësoj se prokurorët dhe oficeret e policisë gjyqësore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec kanë mbatur gjithnjë në vëmendjë gjatë punës së tyre respektimin e të drejtave të njeriut.

Përpos qëllimit kryesor për ushtrimin e ndjekjes penale, nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore shtë mbajtur në konsideratë respektimi i të drejtave themelore dhe parimeve kushtetuese si e drejta për informim, parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i barazisë para ligjit; mosdiskriminimi, e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, e drejta e konfidencialitetit të dhënavë personale qëmund të përfshohen gjatë procesit hetimor, mosmarrja e të dhënavë me anë të dhunës, trajtimi i diferençuar i grave dhe të miturve, e drejta për t'u njojur me akuzen, me shkaqet e arrestimit apo ndalimit etj.

Në zbatim edhe të ndryshimeve përkatesë në Kodin e Procedurës Penale të miratuara me ligjin nr.35/2017 nga ana e prokurorëve/oficerëve janë respektuar kërkesat ligjore të parashikuar në dispozitat përkatesë për viktimat e veprës penale përsa i përket njohjes me të drejtat e parashikuara në nenin 58 të K.Pr.Penale apo për njoftimin e përfundimit të hetimeve dhe akteve proceduriale në zbatim të nenit 327 të K.P.Penale të pandehurit/personit nën hetim dhe viktimate të veprës penale.

### • Tëmiturit dhe grupet vulnerabël, të pandehur dhe viktima

Gjatë vitit 2020, vlerësoj se Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë mbajtur në konsideratë të drejtat e këtyrë grupeve të vecanta shoqërore, si të miturit dhe gratë, si në rastin kur kanë pasur cilesinë e të pandehurit/personit nën hetim, ashtu edhe nëse kanë qënë viktima të veprave penale.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë orientuar prokurorët dhe oficerët për të zbatuar gjatë hetimeve për këto grupe të vecanta shoqërore aktet ligjore specidike si: Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit dhe Udhëzimi nr.5/2018 “Për garantimin e assistencës ndaj viktimate dhe dëshmimtarëve të veprave penale”. Kjo me qëllim që të tregohen të kujdeshëm me masat e sigurimit dhe në përputhje me direktivat që përmban ky kod, që në veprimet procedurale me të miturin në konflikt me ligjin të garantohet detyrimisht prania e mbrojtësi t, psikologut, familjarit, në kryejen në cdo rast të raportit të vlerësimit nga psikologu si edhe në marrjen e masave për njoftimin e organeve vendore kompetentë

për trajtimin social të të miturve. Edhe për të mi turit v i kt ima apo deklarues, janë zbatuar dispozitata ligjore përkatëse që veprimet proceduriale me këta shtetas të kryhen në praninë e psikologut dhe nëse ka qënë rasti, edhe të prindërve.

Në zbatim edhe të ndryshimeve përkatesë në Kodin e Procedurës Penale të miratuara me ligjin nr.35/2017 nga ana e prokurorëve janë respektuar kërkesat ligjore të parashikuar në dispozitat përkatesë për viktimat e veprës penale përsa i përket njohjes me të drejtat e parashikuara në nenin 58 të K.Pr.Penale apo për njoftimin e përfundimit të hetimeve dhe akteve proceduriale në zbatim të nenit 327 të K.P.Penale.

Me të njëjtën rëndësi janë trajtuar edhe cështjet ku cilësinë e viktimate apo të pandehurve e kanë patur femrat. Në këto raste paraqitet problematikë mungesa e oficerëve femra të policisë gjyqësore, te cilat janë të domosdoshme në rastet kur Kodi i Procedures Penale percakton se viktima e dhunës seksuale ose ato të trafi kimit m nd/d u het të pyetet nga një oficer i së nejtës gjini.

Kjo vëmendje e vecantë ka konsistuar edhe në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore te shpejta dhe d i nami ke, si dhe mbajtjen në vëmendje të një politike të drejtë dënimesh në rastet e këtyre të pandeh u rve.

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec nuk ka një seksion për hetimin e cështjeve penale ku të miturit të kenë cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin apo cilësinë e viktimës së veprës penale por është caktuar një prokuror për ndjekjen e hetimit për këtë kategori, i cili ka ndjekur në vazhdimësi trajnimet profesionale të kryera për zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale Për të Miturit.

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar 3 (tre) çështje me të mitur në konflikt me ligjin të gjinisë mashkull dhe 6 (gjashte) çështje me të mitur viktima.

Nga 3 (tre) të pandehurit e mitur në konflikt me ligjin asnjë prej tyre nuk është ndjekur me masën e sigurimit arrest me burg, por 1 (një) është ndjekur me masën e sigurimi "garanci pasurore"; 1 (një) me masën e sigurimit "detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore" dhe 1(një) pa masë sigurimi personale.

Afati i hetimit të çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin ka qënë : 1 (një) është hetuar brenda afatit dy muaj dhe 2 (dy) çështje janë hetuar brenda afatit tre muaj.

Në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin rezulton se 1 (një) çështje është pushuar dhe 2 (dy) çështje janë dërguar për gjykim.

Vetëm për 1 (një) cështje është zbatuar masa e shmangies dhe është aplikuar "Paralajmërim me shkrim"; për 2 (dy) cështje është kërkuar alternativa e dënimit me burgim - nen 59 i K.Penal .

- **Bashkëpunimi Ndërinstitucional**

Gjatë këtij viti, janë mbajtur raporte korrekte me institucionet e tjera në zbatim të ligjit procedural penal dhe ligjit organik "*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*". Në këto marrëdhene rolin kryesor e zënë ato që lidhen me:

Këshillin e Lartë të Prokurorisë;  
Prokurorinë e Përgjithshme, si institucion epror;  
Prokurorinë Pranë Gjykatës së Apelit Korçë;  
strukturat e Policisë së Shtetit, dhe institucionet e tjera që përfshijnë Shërbimet e policisë gjyqësore, për bashkëpunimin dhe raportet që lidhen me fazën e hetimit paraprak;  
Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;  
Me institacione të tjera në nivel lokal dhe rajonal;

#### Raportet me Prokurorinë e Përgjithshme

Gjatë vitit 2019, ka patur një raport bashkëpunimi të ngushte me Prokurorinë e Përgjithshme, dhe me të gjitha drejtoritë dhe hallkat e tjera të saj.

Veçohet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha drejtoritë, dhe sektorët, me dhe në vecanti Sektorit të Përgjimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë.

Vlen të theksohet gjithshtu ndihma dhe bashkëpunimi, me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Përveç diskutimeve për çështje konkrete, është diskutuar dhe mbajtur vazhdimisht kontakt, në lidhje me problematika që kanë të bëjnë veçanërisht me anën teknike e organizative të funksionimit të Prokurorisë.

### Raportet me Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë

Gjatë vitit 2020, është mbajtur një raport shumë i ngushtë me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Përveç raporteve proceduriale që dikton ligji organik i prokurorisë dhe ligji procedural penal, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm në lidhje me ecurinë e çështjeve të apeluara në Gjykatën e Apeit.

Veç kësaj janë zhvilluar diskutime, edhe në lidhje me menyrën e ushtrimit të së drejtës të apelit, praktikën e ndjekur nga Gjykata e Apelit, si dhe problematikat e hasura gjatë gjykimit në këtë gjykatë, dhe që lidhen me fazën e hetimeve paraprake.

### Raportet me strukturat e Policisë së Shtetit

Gjatë vitit 2020, përveç respektimit me rigorozitet të detyrimeve ligure dhe në funksion të rritjes së cilësisë së hetimit paraprak, është synuar forcimi i raportit të ngushtë të bashkëpunimit me të gjitha strukturat e Policsë së Shtetit, veçanërisht me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, si dhe Komisariati i Policisë Pogradec.

Gjatë këtij viti, nga pikpamja formale, janë respektuar urdhërimet e urdhërit të përbashkët, kur procedimet penale janë regjistruar mbi bazën e materialit referues nga shërbimet e policisë gjyqësore.

Hetimet sipas rastit, janë deleguar tek oficeri përkatës i policisë gjyqësore. Nga pikpamja e cilësisë së hetimit, vlen të theksohet se këto raporte kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së hetimit. Çështjet janë trajtuar në kohë, dhe në veçanti në këtë drejtim ka ndikuar dhe vënia në dijeni e prokurorit të gatshëm në momentet e para pas ndodhjes së ngjarjes.

Me drejtuesit e strukturave të policisë së shtetit, janë zhvilluar takime periodike, për mënyrën e organizimit të punës hetimore, mënyrës së përpilimit të akteve proceduriale, përmirësimin e formës dhe përbajtjes së tyre.

Veç diskutimeve në lidhje me çështje të përgjithshme, ka patur diskutime dhe për çështje të vecanta, në lidhje me mënyrën e hetimit të tyre, teknikën, taktikën hetimore, si dhe mjetet e kërkimit të provave që do të përdoren.

## Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec

Gjatë vitit 2020, raportet e kësaj zyre me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, kanë qenë raporte korakte, ligjore dhe proceduriale, në lidhje me kërkesat e paraqitura në seancë paraprake, përfaqësimin e akuzës si dhe kërkesat që lidhen me fazën e hetimeve paraprake.

Gjatë këtij viti, përgjithësisht ka patur një paraqitje të rregullt të prokurorëve në seancat gjyqësore, përvèc ndonjë rasti sporadik, ndërsa nga ana tjetër nga gjyqtarët është konstatuar angazhim i plotë në mbarëvajtjen e gjykimeve, respektimit të solemnitetit, ruajtjen e sekretit etj.

### ○ Bashkëpunimi ndërkombëtar

Me qëllim bashkëpunimin e efektshëm në ushtrimin e ndjekjes penale apo marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, lidhur me veprat penak që kanë kryer shtetasit shqiptare jashtë shtetit, apo shtetasit e huaj në rrethin e Pogradecit, nga ana e Prokurorisë Pogradec janë rnbajtur kontakte të vazhdueshme me Prokurorinë e ërgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, si dy organet kom petente që mundësojnë ndërmjetësimin e bashkëpuni mit me autoritetet e huaja.

### ○ Përdorimi i metodave speciale të hetimit dhe hetimet proactive

Gjatë vitit 2020 kemi patur rritje të përdorimit të metodave speciale të hetimit kryesisht përgjimet e komunikimeve telefonike, përgjime me fotografji apo nëpërmjet vendosjes së pajisjeve të përgjimit (G.P.S), kryesisht në hëtimin e veprave penale në fushën e narkotikëve, veprat penale “shpërdorim detyre”-neni 248 i K.Penal apo në hetimin e veprës penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.Penal. Janë bërë 37 (tridhjetë e shtatë) kërkesa për lejim përgjimi dhe vlefteSIM përgjimi të komunikimeve telefonike, 4 (katër) kërkesa për kontroll ambjenti.

### • Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm

Me qëllim zbat imin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, përvèc masave konkrete të marra për zbatimin e tyre, si mbledhja e prokurorëve dhe diskutimi tyre, janë hartuar udhezimet dhe urdhrat e mëposhtëm:

I.Në lidhje me masat marra për të siguruar zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “*Mbi rregullimin e mardhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarsisë në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm*”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhri nr.3 datë 02.09.2020 “Për krijimin e regjistrat të komunikimeve të brendshme”.

Udhëzimi i përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “*Mbi rregullimin e mardhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarsisë në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm*”, si dhe Urdhri date 02.09.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë iu është njoftuar të gjithë trupës së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqsortë dhe administratës këto dy akte duke iu vënë në dispozicion kopje të tyre.

Regjistri i qarkullimit të brendshëm të akteve është krijuar në Zyrën e Prokurorisë Pogradec prej muajit Shtator 2020, konkretisht prej datës 16.09.2020.

Në strukturën e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Pogradec është vetëm një sektretare e prokurorëve dhe një kryesekretare, e cila është njëkohësisht edhe financiere dhe nga ana tjetër rritja e numrave të regjistrave që duhet të mbahen e vështirëson mbajtjen në mënyrë të rregullt të këtyre regjistrave. Në funksion të përmbushjes me efikasitet dhe në mënyrë të rregullt të pasqyrimit të dhënavët në regjistrat e Zyrës së Prokurorisë, cmoj si të domosdoshme shtimin e numrit të sekretareve në Prokurorinë Pogradec.

Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020 “*Mbi rregullimin e mardhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarsisë në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm*”, nga ana e Drejtuesit janë bërë tre kërkesa për informacion dhe janë nxjerrë dy udhëzime jo të detyrueshme për cështje hetimore.

**II.** Në lidhje me masat marra për të siguruar zbatimin e urdhrit nr.120 datë 08.09.2020 “*Për miratimin e disa shtesave në “Rregulloren Standard të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorive të Juridikzionit të Përgjithshëm*”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë Urdhri nr. 4 datë 11.09.2020 për “Miratimin e “Rregullores Standarde të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”.

Urdhri nr.120 datë 08.09.2020 “*Për miratimin e disa shtesave në “Rregulloren Standard të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorive të Juridikzionit të Përgjithshëm*”, dhe Urdhri i Drejtuesit të Prokurorisë nr. datë 11.09.2020 për “Miratimin e “Rregullores Standarde të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, bashkëngjitur të cilët “Rregullorja Standarde të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec”, iu janë njoftuar të gjithë trupës së prokurorëve , oficerëve të policisë gjyqsortë dhe administratës këto dy akte duke iu vënë në dispozicion kopje të tyre.

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec nuk ka organizime/ndarje në seksione por në përputhje me objektivat institucionale të prokurorisë, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë urdhrat e mëposhtme:

- Urdhri datë 27.07.2020 për caktimin e prokurorit që do të ndjekë grupveprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore sipas parashikimeve në nenin 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.10 datë 17 Korrik 2020 .
- Urdhri datë 03.07.2020 për caktimin e prokurorit në lidhje me ekzekutimet e vendime penale,
- Urdhri datë 03.07.2020 për emërimin e koordinatorit të të drejtës së informimit
- **Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020**

Në lidhje me masat administrative të marra për të siguruar zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe planit të veprimit të miratuar me Urdhrin nr.103 datë 17.07.2020, nga ana ime në cilësinë e Drejtuesit iu është njoftuar të gjithë trupës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqsorë këto dy akte duke iu vënë në dispozicion kopje të tyre. Duke i kushtuar një rëndësi të vecantë zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës, të thjeshtësuara në planin e veprimit të miratuar nga Prokurori i Pergjithshem, në mbledhjet/takimet periodike me prokurorët e oficerët e policisë gjyqsore të Zyrës së Prokurorisë Pogradec janë diskutuar të gjitha masat e nevojshme për konkretizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës në përputhje me objektivat institucionale të prokurorisë. Në mënyrë të vecantë kemi diskutuar dhe dakortësuar me trupën e prokurorëve/oficerëve për ti dhënë prioritet marrjes së masave të tilla si: zgjerimi/thellimi/rritja e efikasitetit në hetimin e elementeve të formave të vecanta të bashkëpunimit me qëllim verifikimin e kompetencës lëndore dhe kalimin më tej për kompetencë në Prokurorinë e Posacme të cështjeve që lidhen me grupveprat penale të krimít të organizuar apo korruptionit; rritja e përdorimit të hetimit proaktiv dhe metodave speciale të hetimit të rëndësishme për krijimin/grumbullimin e provave në hetimin e cështjeve penale; rritja e numrit të hetimeve paralele krahas hetimeve për veprën penale kryesore që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale; rritja e numrit të hetimeve pasurore në zbatim të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar, të ndjekura me rritjen e kërkesave për sekuestrim/konfiskim të aseteve produkte të veprave penale; zhvillimi i takimeve të përbashkëta me agjensitë e tjera ligjzbatusetë përfshira në hetimin e grupveprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit etj.

Gjatë vitit 2020 kemi patur 2 {dy} rast cështje penale për veprën penale “shpërdorim detyre” parashikuar nga neni 248 i K.Penal dërguar për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posacme, cështje keto nga te cilat 1 {nje} eshte pranuar nga kjo Prokurori ndersa 1 {nje} nuk eshte pranuar per kompetence.

Në lidhje me analizat, trajnimet e përbashkëta të kryera me qëllim rritjen e bashkëpunimit institucional në fuknsion të rritjes së efikasitetit dhe kapacitetave profesionale në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimtarisë kriminale, për shkak të situatës të krijuar nga Covid – 19 takime të kësaj natyre kanë qënë më të pakta. Gjithsesi në vazhdimësi janë zhvilluar takime periodike me Drejtuesin e Komisariatit të Policisë Pogradec, Drejtuesin e Drejtorisë Vendore të Policisë Korce dhe me oficerët e ngarkuar me hetimin e këtyre grupveprave penale me qëllim thellimin e hetimit, përdorimin e teknikave të hetimit proaktiv për të patur rezultate pozitive në hetimin e këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2020 kemi patur rritje të përdorimit të metodave speciale të hetimit kryesisht përgjimet e komunikimeve telefonike apo nëpërmjet vendosjes së pajisjeve të përgjimit (G.P.S), kryesisht në hëtimin e veprave penale në fushën e narkotikëve, veprat penale të korruptionit (hetime të cilat për shkak se nuk janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë tonë janë regjistruar fillimisht për vepren pënalet “shpërdorim detyre”-neni 248 i K.Penal) apo në hetimin e veprës penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve” parashikuar nga neni 298 i K.Penal që kete vit kanë shënuar një rritje tej parashikueshmërisë të procedimeve për këtë vepër penale .

Në lidhje me të dhënat e hetimeve të kryera për veprën penale të pastrimit të parave sipas tipologjive përkatëse për vitin 2020 janë regjistruar 2 {dy} procedime penal për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal; një procedim penal për veprën penale “mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë” parashikuar nga neni 179/a të K.Penal; dy procedim penal për veprën penale “punësim i paligjshëm” parashikuar nga neni 170/a të K.Penal; dy procedim penal për veprën penale “fshehje e të ardhurave” parashikuar nga neni 180 të K.Penal; shtatë procedime penale për veprën penale “kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” parashikuar nga neni 172 i K.Penal; një procedim për nenin 174; një procedim për nenin 178 e një procedim për nenin 179 .

Në lidhje me hetimet financiare/pasurore sipas tipologjive dhe sekuestrimin e aseteve/produkteve të veprës penale gjatë këtij 9 mujori kemi tw regjistruar vetëm dy raste të hetimeve pasurore por nuk kemi patur raste të sekuestrimit apo konfiskimit të aseteve/produkteve të veprës penale. Duke patur në vëmëndje se numri i cështjeve të finalizuara me sukses në hetimin/gjykimin e grupveprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, hetimit financiar/pasuror/sekuestrimi i aseteve/produkteve të veprës penale është i ulët, trupa e prokurorëve të Zyrës sonë e ka në vëmëndje të shtuar rritjen e numrit dhe efikasitetin në hetimet e këtyre grupveprave penale. Në funksion të kësaj përvèc takimeve peroidike me oficerët e policisë gjyqsortë të seksionit përkatës në Komisariatin e Policisë dhe Drejtorenë Vendore të Policisë për të diskutuar problemtatikat/vështirësit dhe sfidat në hetimin e këtyrë grupveprave penale, cmoj si të nevojshëm trajnimin vazhdues profesional të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqsortë për teknikat e hetimit të këtyre grupveprave penale.

- Informacion mbi zbatimin e "Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020"

Në kuadër të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 dhe Plant të Veprimit të Miratuar me Urdhrin nr.12 datë 27.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, vleresoj se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të parashtruara në këto akte nënligjore janë përbushur nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec në perputhje me juridikcionin e saj dhe kompetencën lëndore e terri toriale. Disa prçj kërkesave le rezolutes ja ne faklikisht rubri ka dhe gjetje me vete te kctij raporti sic; eshte:

- kryerja e hetimeve proaktive nepërmjet metodave speciale të hetimit
- forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë dhe policisë gjyqësore,
- irritja e bashkëpunimit me organet vendore e qëndrore,
- irritja dhe konsolidimi i bashkëpu ni mit me autoritetet e huaja gjyqësore, bashkëpunim ky që realizohet me ndihmën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë,
- ashpërsimi i politikës së dënitit në rastet e veprave penale të dhunës në familje, krimite ekonomik e financiar, personave perserites etj
- ndjekja e një politike dënimisë më të butë për kategoritë si gratë, personat me aftesi të kufizuar, të moshuarit etj;
- aplikimi i institutive të reja procedurale sigjykimi memarrëveshje dhe urdhri penal etj,

Në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, prokurorët ndonëse të paktë në numër, kanë bashkëpunuar ngushtësish me shërbimet e policisë gjyqësore, në shkëmbimin e informacionit dhe kryerjen e hetimeve.

Megjithatë vlen të theksohet, se referimet nga policia gjyqësore, për rastet e veprave penale që lidhen me krimin e organizuar, korruptionit dhe pastrimit të produkteve të vepres penale, kanë qenë të pakta në numër. Pavarësisht nga numri i pakët i kësaj kategorie çështjesh, nuk kanë qenë të pakta në numër hetimet proaktive që janë inicjuar dhe janë ndjekur në dinamikë dhe me metoda hetimi 37 (tridhjetë e shtatë) kërkesa për lejim përgjimi dhe vleftësim përgjimi të komunikimeve telefonike.

Në vitin 2020 nga Policia e Shtetit janë referuar 705 (shtatëqind e pesë) materiale kallëzuese, por vlen të theksohet se shumë nga këto materiale kallëzuese kanë përfunduar me vendime mosfillimi rrëth 213 (dyqind e trembëdhjetë) të tillë. Shumica e procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e materialeve referuese të ardhura nga

Policia e Shtetit, u janë deleguar përsëri oficerëve të policisë gjyqëore pranë kësaj strukture.

– Në lidhje me veprat penale të kryera nga të miturit ose ndaj të miturve, dhe zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, vlen të theksohet se nga ana e prokuroreve janë zhvilluar një sërë trainimesh me qëllim rritjen e kapacitetit dhe eficencës në lidhje me zbatueshmërinë e tij.

Periudhën e fundit të vitit, pas trainimeve të organizuara, si dhe praktikës së Gjykatës së Lartë dhe vendimarrjeve të Këshillit të lartë Gjyqsëor, është diskutuar dhe me Komisariatin e Policisë Pogradec, Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë si dhe me Prokurorinë Pranë Gjykatës së Apelit Korçë, në plotësim të detyrimeve që burojnë nga zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, hetimi dhe gjykimi i çështjeve me të mitur të bëhet nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, dhe Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet me aq sa kemi konstatuar dhe që mund të sjellë një problematikë të shtuar në të ardhmen, mungesa e psikologeve në Rrethin e Pogradecit, në mënyrë që të asistohen të miturit që në momentet e para të kontaktit me organet e procedimit penal.

– Në lidhje me veprat penale të "Dhunës në familje", edhe në vitin 2020, është vijuar me standartin e një politike përgjithësisht të fortë penale, ku të pandehurit janë gjykuar kryesisht me masën e sigurimit "Arrest në hurg" dhe lloji i denimit ka qenë përgjithësisht me burgim. Vlen të theksohet, se gjatë vitit 2020, ka patur një renie të numrit të veprave penale të "Dhunës në familje" vetëm në 17 (shatëmbëdhjetë) çështje të regjistruara, nga të cilat 14 (katërbëdhjetë) janë dërguar për gjykim.

– Në lidhje me veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i K.Penal, gjatë vitit 2020, janë regjistruar 22 (njëzet e dy) procedime penale. Përgjithësisht këto procedime, kanë patur si mënyrë të kryerjes së veprës penale atë të mbajtjes të lëndeve narkotike, dhe në 13 (trembëdhjetë) raste në doza të vogla për të cilat është kërkuar pushimi në gjykatë. 9 (nëntë) prej këtyre çështjeve janë dërguar për gjykim.

Vlen të theksohet se pas krijimit dhe fillimit nga puna, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimtit të Organizuar, parashikohet një rritje e numrit të çështjeve në lidhje me narkotikët, konkretisht rritje e numrit të hetimeve që kanë të bëjnë me veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" parashikuar nga neni 283/a I K.Penal, për vetë specifikat e territorit ku shtrin veprimtarinë e saj Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, territory në të cilin ka një vijë të konsiderueshme kufitare.

Në vitin 2020, janë regjistruar 2 (dy) procedime penale për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287 i K.Penal dhe 1 (një) procedim per vepren penale "Mosdekclarim ne kufi te te hollave dhe sendeve me vlere" të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal.

- ⇒ Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim, rezulton se nga 230 (dyqind e tridhjetë) çështje të dërguara për gjykim, 16 (gjashtëmëvdhjetë) procedime janë përfunduar me marrëveshje dhe 5 (pesë) procedime me urdhra penale. Të gjitha marrëveshjet dhe urdhërat penale janë miratuar nga gjykata.
- Në lidhje me masat dhe llojet e dënimit, mund të saktësojmë se është bërë një politikë e mirë penale, ndaj autorëve të veprave penale, dhe *dënimet alternative* për veprat penale të lehta zënë një numër të konsiderueshëm, në raport me numrin e përgjithshëm të dënimeve të dhena nga gjykata. Rezulton se se dënimi me gjobë është aplikuar në 42 (dyzet e dy), në 62 (gjashtëdhjetë e dy) raste është aplikuar dënnimi me kusht sipas nenit 59 të K.Penal, në 3 (tre) raste është aplikuar zëvendësimi i dënimit me kryerjen e një punë ne interes publik. Ndërkohë dënnimi me burgim është aplikuar në 147 (njëqind e dzyet e shtatë) raste.
- Gjatë këtij viti sikurse u tha dhe në pjesët e tjera të raportit, me qëllim shmangien sa më shumë të masës së sigurimit "*Arrest në burg*", rezulton se në 25 (njëzet e pesë) raste, Gjykata ka vendosur masën e sigurimit "*Garanci pasurore*" parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, dhe prokuroret në ndryshimet që i janë bërë dispozitës, kanë qenë përgjithësisht dakort dhe i kanë pranuar ato në seancë.
- Përgjatë vitit 2020 nuk ka patur të regjistruara procedime penal mbi bazën e kallëzimeve të ardhura nga K.L.SH apo nga sektori i Verifikimit të Identitetit në Prokurorinë e Përgjithshme.
- ⇒ Pergja te vitit 2020, ka viju ar te mbetet problematike mungesa e referi meve per vepren penale le korru psionit nga ana e insti!ucioneve te tjern ligjzbati uese, te cilat kane detyren funksionale te mbledhjes se informadoneve se kete drejtim, si; mu nd te jetc Policia e Shtetit, Sherbimi Informativ Shtetror, Drejtoria e Përgjithshme e Parandal imit te Pastrimit te Parave apo dhe institudone te tjera si Drejtoria e Hetimit Tatimor etj.

Ne drejtim te forcimit te kapaciteteve profesionale te prokurorëve dhe oficereve ne periudhen raportuese kane munguar trajnimet e perbashketa me agjensite ligjzbatusë te perfshira ne luftën kunder korrupsionit (vetëm dy trajnime të organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme).

Në lidhje me pavarsinë e prokurorëve, mund të themi se po konsolidohet në mënyrë të kënaqshme pavarsia e prokurorëve, që nga faza e regjistrimit të materialeve kallëzuese e deri në përfundim të fazës së hetimeve paraprake. Në këtë drejtim ka ndihmuar edhe procedura e shortit elektronik. në zabtim të Urdhrit nr.3 datë 29.12.2016 “për shpërndarjen e cështjeve në prokurori”.

Përjashtim është kryer për materialet me të arrestuar apo me kërkesa për hetime proaktive që i kanë kaluar prokurorit të gatshëm sipas grafikut mujor të gadishmërisë.

Po kështu në disa raste nga ana e Drejtuesit, në mbështetje dhe zbatim të neneve 42, dhe 53 pika 2 dhe 4 të Ligjit Nr.97/2016 datë 06 Tetor 2016 “*Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, si dhe Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshem Nr.03 datë 29 Dhjetor 2016 “*Për shpërndarjen e cështjeve në prokurori*”, pika 4 e Kreut 1 duke marrë në konsideratë transferimet apo emerimet e reja të prokurorëve dhe gjithnjë duke marrë në konsideratë faktin që këta dy prokurorë nuk kanë patur në hetim asnjë procedim penal, ngarkesën e konsiderueshme të prokurorëve të tjera, në respektim të parimit të barazise dhe proporcionalitetit në shpërndarjen e cështjeve, ka nxjerrë disa urdhra për mos hedhjen e shortit elektronik por për shpërndarjen manuale të cështjeve.

Mund të themi se është evidentuar një nivel i kënaqshëm i respektimit të standardeve etike dhe profesionale, në funksion të forcimit të integritetit.

Lidhur me aksesin e prokuoreve dhe oficerëve te policisë gjyqesore ne databaset shteterore ende konstatohet se nu k eshte arritur qe te realizohet në mënyre efektive nga pikepamja teknike. Aktualisht, eshte ne funksion dhe eshte permiresuar sistemi lidhur me administrimin e certifikates elektronike te gjendjes gjyqesore apo certifikatave personale/familjare. Problematike mbetet aksesi në database e ASHK për shkak të tarifave që duhet të paguhen dhe mungesën e IT-se apo trajnimin e prokurorëve/oficerëve për të aksesuar në këtë database.

Duke marre ne konsiderate gamen e gjerë te informacioneve qe duhet te shqyrtohen gjate hetimit te veprave penale te t illa, eshte e nevojshme zgjerimi dhe mundesimi i aksesit edhe ne database te tjera si sistem i TIMS, te dhenat nga DPSHTRR, Drejtorite e Doganave, Kufirit, Tatimeve etj, me qellim rritjen e shpejtesise dhe efikasitetit ne hetim.

Pavaresisht se konstatojme qe veprimtaria e Prokurorise ka qene ne perputhje me kerkesat e mesiperme, vleresojme. se ka vend ende per permiresimin e treguesve te mesiperme, qellim ky i cili arrihet jo vetem me punen e Prokurorise, por edhe me vullnetin dhe bashkëpnuimin e organeve të tjera shteterore si Kuvendi, organet e pushtetit ekzekutiv, ministrite dhe i nstitucionet në varesi te tyre, institucionet e tjera te pavarura si KLSH, ILDKPKI. etj.

#### • **Problematikat e konstatuara**

Përgjatë vitit 2020 kemi konstatuar problematikat e mëposhtme, të cilat kanë qënë të prejardhura dhe janë akumulim vit pas viti i këtyre problematikave si më poshtë:

1. Problematikat lidhur me ngarkesën e lartë të punës në kuadër të mungesave në organikën e prokurorëve dhe oficerëve. Nga analiza e statistikave, që do të bëhen prezente në vijim të raportit, rezulton se ngarkesa efektive për

prokurorët e Prokurorisë Pogradec është mbi 400 dosje hetimore, në ndryshim nga viti paraardhes ku kishte mbi 300 dosje. Kjo ngarkese i referohet prokurorëve Shkëlqim Kokona , Dorina Bejko dhe Gjergji Ceka, të cilët kanë përballuar ngarkesën efektive të Prokurorisë, ndersa prokurorët Gazmedn Frengu është ëmruar vetëm në muajin Tetor 2020 . Nga kjo e dhene është e nevojshme që të parashikohet shtim në organiken e Prokurorisë me oficerë te policisë gjyqcsore dhe personel administrative si sekretare prokurori. Po kështu me rëndësi vlerësoj që të studiohen mundësitë nga pikepamja e ligjit per st atusin e magjistratit, së bashku me KLP-ne, për përsëritjen e transferimit 1-një vjecar të prokurorit Gjergji Ceka edhe pas datës 01.07.2021 me qëllim perballimin e ngarkesës dhe përfundimin e dosjeve të mbart ura. Kjo do të kishte ndikim të drejtperdrejte në rritjen e cilësisë se punes së prokuroreve dhe oficereve te policise gjyqesore, si edhe do te mundesonte ushtrimin e njekjeve penale efektive dhe zhvillimin e hetimeve te shpejta. Per vitin 2020 konstatohet nje rritje e ngarkesës per prokuroret qe shkon deri ne 50% me shume krahasuar me vitin 2020 cka e ben te domosdoshme plotësimin e organikës me 4 prokurorë dhe shtimin e oficerëve të policisë gjyqesore duke e berë trupën e oficereve më 3 (tre) të tillë.

2. Problematikat lidhur me pamundesine per te kryer ekspertime ne disa fusha te vecanta, per shkak te mungeses se legjislacionit perkates, por edhe mungeses se vullnetit apo pam undesise se disa institucioneve shteterore per t'i dhene pçrgjigje cështjeve të ngritura nga Prokuroria.. Si rrjedhoje e kesaj situate, e cila vleresojme qe do te na vere perballe rasteve te shumta te kesaj natyre, eshte e nevojshme bashkerendimi ne nivel qendror me institucionet publike per te asistuar Prokurorine ne hetimet përkatëse.

3. Problematika lidhur me mungesen e psikoogeve per te asistuar ne ceshtjet penale me te mitur viktima apo ne konflikt me ligjin apo kryer raportin e vleresimit {RIP} per te miturit ne konflikt me ligjin.

## **II.Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë**

### **• TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**


Në vitin 2020 janë mbartur **267** (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) procedime penale nga viti 2019.

Përgjatë vitit **2020**, janë regjistruar në Regjistrin e Njoftimeve te Veprave Penale **748** (shtatëqind e dyzet e tetë) materiale kallëzuese, ndërkokë që në vitin **2019** janë regjistruar në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale, **795** (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) materiale kallëzuese ndërsa në vitin 2018 ishin regjistruar 834 (tetëqind e tridhejtë e katër) materiale kallëzuese. Sikurse vihet re, janë trajtuar nga prokuroret, një numër i përafërt cështjes, me rreth **47** (dyzet e shtatë) materiale kallëzuese më pak se në vitin 2019. Nga **748** (shtatëqind e pesedhjetë e katër) materiale kallëzuese, të regjistruara në Regjistrin e Njoftimeve të veprave Penale në vitin **2020**, janë regjistruar **504** (katërqind e tetëdhjetë e tre) procedime penale, ndërkokë që për **213** (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) kallëzime është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Ndërkokë që në vitin **2019** janë regjistruar në Regjistrin e Njoftimeve të Veprave Penale, **499** (dyqind e gjashtëdhjetë e katër) procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për **323** (dyqind e shtatëdhjetë e dy) të tillë.

Sikurse rezulton gjatë vitit **2020**, janë regjistruar rreth **5** (nëntë) procedime penale, më shumë se ne vitin paraardhës **2019** dhe është ulur numri i rasteve të mosfillimit me rreth **110** vendime mosfillimi më pak.

Në lidhje me subjektet kallzuese rezulton se **3** (tre) kallzime janë kryer nga institucionet publike; **20** (njëzet ) kallzime janë kryer nga shtetasit dhe **705** (shtatëqind e pesë) materiale kallzuesë janë përcjellë nga organet e policisë.

Në lidhje me përfundimin e procedimeve penale, raportin e menyrës së përfundimit po e paraqesim në grafikun më poshtë.



Nga tërësia e cështjeve të sipërcituara, janë mbartur për në vitin 2021, **356** (njëqind e shtatëdhjetë e tete) procedime penale.

Gjatë vitit **2020**, është përfaqësuar organi i prokurorisë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në **20** (njëzet) cështje me të dëmtuar akuzues.


## NË TOTAL:

Në vitin **2020** duke përfshirë dhe cështjet e mbartura nga viti **2019**, është ushtruar ndjekje penale në hetimin paraprak për **1015** (njëmijë e pesëmbëdhjetë) procedime penale (materiale kallëzuese) nga **1034** (njëmijë e tridhjetë e katër) të tilla në vitin **2019**, dhe **1040** (një mijë e dyzet) që ishin në vitin **2018**.

Pra gjatë vitit 2020, është ushtruar ndjekje penale në fazën e hetimit paraprak për 19 (nëntëmbëdhjetë) çështje penale e materiale kallëzuese **më pak** se viti 2019 por duhet patur në vëmendje fakti se deri në datën 01.07.2020 në organikën e Zyrës së Prokurorisë Pogradec kanë qënë efektivë në short vetëm dy prokurorë Z.Shkëlqim Kokona dhe Dorina Bejko. Kjo pasi prokurori Erion Pustina është larguar nga detyra në datën 11.02.2020 (me dorëheqje) ndërsa prokurori Sotir Kllapi në datën 21.05.2020 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Posacme. Me vendimin e datës 26.06.2020 te Këshillit të Lartë të Prokurorisë prokurori Gjergji Ceka

është transferuar për të kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec dhe me vendimin e datës 15.10.2020 të Këshillit të lartë të Prokurorisë është caktuar në detyrë si prokuror ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec Z.Gazmend Frëngu, duke u plotësuar tashmë organika më tre prokurorë dhe Drejtuesen.

E shprehur në përqindje, rezulton se veprat penale kundër autoritetit të shtetit zënë numrin më të madh të cështjeve një shifër prej 279 cështje - 37,2 %, veprat penale kunder pasurisë zënë një shifër prej 220 cështje- 29,4 %, veprat penale kundër personit zënë një raport prej 164 cështje - 21,9 % të numrit të përgjithshëm të cështjeve, vepra penale kundër mjedisit zënë një shifër prej 26 cështje -3,5 % dhe 9 % veprat penale të tjera.



- **Kriminaliteti sipas perhapjes së veprave penale dhe tendencave të tvore**

Lidhur me gjëndjen e kriminalitetit giatë vitit 2020, në dallim me dy vitet paraardhëse, është vënë re një **ulje** e numrit të rasteve të kryerjes së veprave penale e “*Vjedhjes*” parashikuar nga neni **134** të K.Penal, në 66 raste ose % nga 84 raste në vitin 2019; vihet re ulje e numrit të rasteve të kryejres së veprave penale “*Prodhim e shitje e narkotikëvë*” parashikuar nga neni **183** i K.Penal në 22 raste për vitin 2020 nga 52 raste që kanë qënë regjistruar në vitin 2019; Nga ana tjeter konstatohet rritje e numrit të rasteve të kryerjes së veprës penale “*shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*” parashikuar nga neni **290** i Kodit Penale në 27 raste nga 15 raste që ka patur në vitin 2019 ndersa treguesit per nenin **291** kane qënë thuajse në të njëjtin nivle në 33 raste nga 37 raste që kanë qënë në vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 në dallim nga vitet paraardhëse është konstatuar një rritje e numrit të kryerjes së veprës penale “*ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve*” parashikuar nga neni **298** i Kodit Penal në 59 raste nga 16 raste që janë regjistruar në vitin 2019. Ndërkohë që vihet re ulje e numrit të rasteve të regjistrues për veprën penale “*kalim i paligjshëm i kufijvë*” parashikuar nga neni **297** i Kodit Penal në 20 raste nga 53 raste që kanë qënë të regjistruara në vitin 2019.

Rritje e numrit të cështjeve të regjistrues konstatohet edhe për grupveprat penale kundër punonjësve të policisë së rendit publik, ku rezulton se për vitin 2020 janë regjistruar 22 rastë për veprat e parashikuara nga neni **236** e **242** i Kodit Penal ndërkohë që për vitin 2019 ishin regjistruar vetëm 10 rastë për këto dy vepra penale.

Përsa i pëkret grupveprave penale që kanë qënë në objektivat e hetimit të organeve të policisë në vitet paraardhëse si neni **130/a** apo **291** të Kodit Penal, për vitin 2020 rezulton se vepra penale “*dhunë në familje*” parashikuar nga neni **130/a** i Kodit Penal është pothuaj në të njëtin nivel me vitin 2019 ( **17** raste per vitin 2020 nga **15** raste për vitin 2019).


Po kështu edhe vepra penale “*ndërtim i paligjshëm*” parashikuar nga neni **199/a** i Kodit Penal është pothuaj në të njëtin nivel me vitin 2019 ( **18** raste per vitin 2020 nga **22** raste për vitin 2019).

Tabela më poshtë jep një përbledhje të të gjitha procedimeve penale për të cilat është ushtruar veprimtaria hetimore përgjatë vitit 2020, si dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

| Materiale penale          | Numri | Nr. pers nen hetim | Nr. pandehurve | Të arrestuar |
|---------------------------|-------|--------------------|----------------|--------------|
| Mosfillimet               | 213   | 0                  | 0              | 0            |
| Mbartura                  | 267   | 130                | 80             | 15           |
| Rregjistruar proc. penale | 504   | 263                | 165            | 68           |

|                                      |             |            |            |           |
|--------------------------------------|-------------|------------|------------|-----------|
| Rifilluar të pushuara <sup>1</sup>   | 1           | 1          | 1          | 0         |
| Rifilluar të pezulluara <sup>2</sup> | 86          | 0          | 0          | 0         |
| Gjithsej                             | <b>1071</b> | <b>393</b> | <b>245</b> | <b>85</b> |

Në lidhje me numrin e përgjithshëm të cështjeve, si dhe raportin e sejcilës vendimarrje me numrin e përgjithshëm të cështjeve, paraqitet grafiku i mëposhtëm.



- **Kriminaliteti sipas shtrirjes territorial**

Bashkia Pogradec përfshin qytetin e Pogradecit dhe 7 (shatë) njësi administrative (Bucimas, Cërrave, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Velcan dhe Udënsisht). Nga të dhënat statistikore rezulton se gjate vitit 2020 se shtrirjen më të madhe të kriminalitetit e ka qyteti i Pogradecit me 510 (pesqëind e dhetë) materiale kallzuese per vitin 2020, ndërsa 7 njësите administrative rezultojnë në total me 504 (pesqëind e katër) materiale kallzuese të regjistruara për vitin 2020. Nga nësitë administrative rezulton me shtrirje më të madhe të kriminalitetit Njësia Administrative Bucimas me 101 (njëqind e një) materiale kallzuese për vitin 2020 që është rrëth dyfishi i materialeve kallzuese krahasuar me njësitë e tjera administrative.

<sup>1</sup> Numri i cështjeve te pushuara te rifilluara nuk jane raportuar ne statistiken vjetore 2020

<sup>2</sup> Numri i cështjeve te pezulluara te rifilluara nuk jane raportuar ne statistiken vjetore 2020

- **Volumi i punës në fazën e hetimeve paraprake**


MATERIALE KALLËZUESE PËR TË CILAT NUK ËSHTË FILLUAR PROCEDIMI PENAL

Përgjatë vitit **2020**, është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal për **213** (dyqind e trembëdhjetë) materiale kallëzuese nga **323** (treqind e njëzet e tre) në vitin 2019 dhe **362** (treqind e gjashtëdhjetë e dy) materiale kallzuese te mosfilluara në vitin 2018, ndërsa pjesa tjetër e materialete kallëzuese janë regjistruar në regjistrat e procedimeve penale, ose i përkasin ditëve të fundit të vitit **2020**. Në lidhje me materialet kallëzuese për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, rezulton se është një numër i me i ulët se viti 2019 me rreth **110** (njëqind e dhjetë) cështje më pak ndërkohë që në krahasin me vitin 2018 është rreth **149** (njëqind e dyzet e nëntë) materiale kallzuese më pak në të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

E shprehur në përqindje sipas llojit të veprave penale:

- 7 raste - 3,2 % e kallëzimeve/referimeve për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, e zënë rastet e veprës penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*” parashikuar nga neni 290 I K.Penal.
- 26 raste - 12.2 % rasteve kanë të bëjnë me vdekje aksidentale, me vetvrasje të lidhura me veprën penale të “*Shkaktimit të vetvrasjes*”, parashikuar nga neni 99 I K.Penal, duke përfshirë këtu dhe rastet kur kemi të bëjmë me vdekje natyrale;
- 27 raste - 12.7 % e rasteve të mosfilluara kanë të bëjnë me veprën penale kundër pasurisë të “*Vjedhjes*”, “*Shkatërrimit të pronës*” dhe “*Mashtrimit*” parashikuar nga neni 134, 150, 151 dhe 143 i K.Penal;
- 10 raste - 4.7 % e kallëzimeve/referimeve për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, e zënë rastet e veprës penale të “*Fshehjes se të ardhurave*” parashikuar nga neni 180 I K.Penal.
- 60 raste - 28.1 % e rasteve e përbëjnë veprat penale kundër personit, kryesisht të “*Dëmtimeve të tjera me dashje*” dhe “*Kanosjes*” apo dhe “*Plagosjes së lehtë me dashje*” parashikuar nga neni 90, 84 dhe 89 të K.Penal;
- 18 raste - 8.4 % e rasteve përbëjnë veprat penale kundër autoritetit të shtetit kryesisht veprat penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” apo “*Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë a funksion publik*”, “*Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik*” dhe “*Mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik*” parashikuar nga nenet 248, 235, 236 dhe 242 të K.Penal.
- 30.7 % të rasteve e përbëjnë veprat penale të tjera.

Përqindja e secilës kategori veprash penale, duke patur parasysh ndarjen në krerë të K.Penal, në rastin e vendimarrjes për mosfillimin e procedimit penal, po e paraqesim në grafikun më poshtë.



Në rastet e mosfillimit të procedimit penal, janë respektuar detyrimet e ligjit procedural për njoftimin e vendimeve personave të interesuar, të cilëve u njihet e drejta për të ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë.

Gjatë këtij viti, është synuar që kur nga materiali fillestar nuk rezultonin elemente të mjaftueshëm për fillimin e cështjes penale, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, pasi bënин verifikimet e nevojshme, dhe nuk sigurohen të dhena të tjera, çështjet nuk jane filluar, duke u vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Megjithatë, në këtë vit ka patur raste të shtimit të regjistrimit të procedimeve penale, për shkak edhe të ndryshimeve ligue në K.Pr.Penale, ku është vendosur afati i mosfillimit të procedimit penal 15 ditë, dukshëm më i shkurtër se ai që respektohej me parë afati tridhjetë ditor ndonëse ka qenë orientuese.

Megjithatë, duke u referuar dhe në ndryshimet përkatëse, rezulton se ka një ndryshim të raportit të cështjeve për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për shkak se është shtuar kategoria e veprave penale që ndiqen me ankimin e të demtuarit apo viktimës, sikurse janë “*Kanosjes*” apo “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*” parashikuar nga nenet 84 dhe 290/1 i K.Penal.

Zakonisht, edhe me parë, për çështjet të cilat nuk janë regjistruar si procedime penale në regjistrat përkatës, është respektuar afati 30 ditor nga dita e regjistrimit si material kallëzues, deri në datën e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

Megjithatë vlen për tu theksuar, që këto afate nuk janë respektuar në mënyrë rigorozë në të gjitha materialet kallëzuese, për shkak të vonesave në administrimin e akteve të ekspertimit veçanërisht të akteve të ekspertimit mjeko-ligjor që kryen pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, aktet e

ekspertimit autototeknik, apo aktet e ekspertimit biokimik, për të përcaktuar llojin e lëndës narkotike të sekuestruar.

Veç kësaj, ka raste që të dëmtuarit nuk paraqiten për ekzaminim para Shërbimit Mjekoi-Ligjor Pogradec, dhe si rrjedhojë nevojitet pyetja e tyre përsëri, në mënyrë që të arrihet në një konkluzion më të saktë.

Në vendimet e mosfillimit të procedimeve penale, vlen të theksohet se vetëm 14 (katërmbëshjetë) prej tyre janë ankimuar në gjykatë.

Nga **14** (katërmbëdhjetë) çështje të ankimuara, për **12** (dymbëdhjetë) është vendosur mospranimi i kërkesës, ndërsa për **2** (dy) raste, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur prishjen e vendimit duke urdheruar regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve.

Në lidhje me çështje që referohen kryesisht nga policia e shtetit, për të cilat është konstatuar se i dëmtuari nga vepra penale, duhet të ngrejë akuzë private drejtpërdrejtë në gjykatë, pra për veprat penale të parashikuara nga nen 59 i K.Pr.Penale, gjatë këtij viti është konsoliduar praktika e filluar në vitin paraardhës, sipas të cilës prokurori konkludon me vendim për mosfillimin e procedimit penal.

Në lidhje me këtë kategori veprash penale, rezulton se prokuroret janë paraqitur për të përfaqësuar Prokurorine si palë e interesuar, në përputhje me nenin 59/2 të K.Pr.Penale në **20** (njëzet) çështje të tillë:

Në lidhje me çështjet, (materiale kallëzuese) për të cilat nuk është regjistruar procedimi penal, dhe për të cilat është konkluduar me një vendim mosfillimi, vlen të theksohet fakti se gjatë këtij viti ka një numer më të ulët se vitet e mëparshme. Kjo për shkak edhe të ndryshimeve ligjore në K.Pr.Penale, ku është vendosur afati i mosfillimit të procedimit penal 15 ditë, dukshëm më i shkurtër se ai që respektohej me parë afati tridhjetë ditor ndonëse ka qenë orientuese.

- **VEPRIMTARIA PROCEDURIALE NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK**
- **Masat e sigurimit personal**

Gjatë vitit 2020, treguesit e **arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve**, të kryera ndaj shtetasve të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale paraqitet si më poshtë: Janë **arrestuar në flagrancë** nga policia gjyqësore **200** (njëqind e dyzetë e gjashtë) persona nga **145** (njëqind e dyzetë e dy) persona në vitin 2019 dhe nga **146** në vitin 2018).

Nga këto arreste nga ana e prokurorit janë vlerësuar se nuk kanë ekzistuar kushtet e arrestit në flagrancë dhe është urdhëruar lirimi i menjëhershëm për **2 (dy) raste**.

Janë nxjerrë urdhra ndalimi nga prokurori pér 1 (dymbëdhjetë) persona, ndërsa janë ndaluar nga policia gjyqësore 3 (pese) persona.

Janë dërguar në gjykate 202 (njëqind dyzete e pese) kerkesa per vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe ndalimit, **një numër më i lartë krahasuar** me atë të vitit 2019 nga **145 (njëqind e tridhjetë e shtatë) të tilla.**

Nga kërkuesat drejtuar gjykatës, pér vleftësimin e ligjshëm të arrestimeve dhe ndalimeve, gjykata ka vleftësuar si të ligjshme 198 (njëqind e dyzetë e katër) prej tyre ndërsa 4 (dy) të paligjshmëria e arresteve/ndalimeve, ka patur të bëjë kryesisht me kohen e kaluar që nga koha në të cilën është kryer vepra penale dhe deri në momentin e arrestimit, apo pér raste kur nuk kanë ekzistuar kushtet, pér shkak se duhej të operohej me urdhër ndalimi nga prokurori dhe jo ndalim me iniciativë.

Gjatë këtij viti janë kërkuar **nëga prokurori 145** (gjashtëdhjetë e gjashtë) masa sigurimi “*Arrest në burg*”, pér rastet e arresteve ne flagrancë dhe ndalimeve, ndërkokë që **gjykata** e ka vendosur këtë masë në **89** (pesëdhjetë e shtatë) raste.

Në zbatim të nenit 236 të Kodit të Procedurës Penale gjykata ka caktuar masën e sigurimit “*arrest në burg*” pér 25 raste dhe ka pranuar kërkuesën e të arrestuarit pér zëvendësimin e arrestit në burg me garanci pasurore.

Janë kërkuar nga prokuri **9** (nëntë) masa sigurimi “*Arrest në burg*” **në mungesë** të personave nën hetim, dhe gjykata i ka pranuar të gjitha kërkuesat.

Në disa raste masat e sigurimit “*Arrest në burg*” janë kërkuar me afat, pér efekt të administrimit kryesisht të akteve të ekspertimit autoteknik, në rastet e aksidenteve, apo në rastet e ekspertimit mjeko-ligjor dhe vecanërisht toksikologjiko-ligjor. Konkretisht në 4 (nje) raste masa e sigurimit “*Arrest në burg*”, është kërkuar me afat, me qëllim administrimin e provave të reja, dhe gjykata ka vendosur “*arrest ne burg me afat*” në 7 (dy) raste atë.

Janë kërkuar në **31** (gjashtdhjetë e një) raste masa sigurimi “*Detyrim pér tu paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe gjykata e ka vendosur këtë masë në **51** (shtatëdhjetë e katër) raste. Në lidhje me masën se sigurimit personal “*Arrest në shtepi*”, është treguar kujdes në mënyrën e aplikimit të saj, dhe sikurse rezulton është kërkuar rrallë herë aplikimi i saj, ndërkokë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku në 20 raste është kërkuar kjo masë sigurimi, ndërsa gjykata ka vendosur ne 28 raste.

Po kështu është zëvendësuar masa e sigurimit “*Arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, me atë të “*Detyrimi pér tu paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, pér 3 (tre) persona; është zëvendësuar masa e sigurimit “*Arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, me atë të “*garancise pasurore*” parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale, pér 3 (tre) persona; është zëvendësuar masa e sigurimit “*Arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, me atë të “*Arrestit ne shtepi*” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, pér 3 (tre) persona;

Nga sa rezulton, edhe këtë vit i është kushtuar rëndësi vlerësimit të kushteve objektive të cilat kanë çuar në arrestimet në flagrancë apo ndalimet e personave të dyshuar, me qëllim që të shmanget vleftësimi si i paligjshëm për to nga gjykata.

Në lidhje me masat e sigurimit, është treguar kujdes veçanërisht në kërkimin e masës shtrenguese të sigurimit personal atë të “*Arrestit në burg*” dhe atë të “*Arrestit në shtëpi*”. Synimi është që, kjo masë të kërkohet vetëm në rast se cdo masë tjetër është e papërshtatshme, dhe të shmanget kjo masë kur të dhënat në lidhje me akuzën nuk janë të konsoliduara që në momentin që bëhet kërkesa në gjykatë.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2020, prokurorët nuk kanë pushuar cështje apo akuza, për personat që kanë qenë me masë sigurimi “*Arrest në burg*”. Në disa raste sikurse u tha më sipër, kur provueshmëria e elementeve tëveprës penale ka qenë e dyshimte, masat e sigurimit “*Arrest në burg*” janë kërkuar me afat, kryesisht për administrimin e akteve të ekspertimit, vecanërisht autoteknik, dhe ekspertimet toksikologjiko-ligjore.

Nga tërësia e masave të sigurimit personal janë apeluar nga prokurorët **12** (katër) raste, nga të cilat Gjykata e Apelit Korçe, ka pranuar vetëm 2 (dy) prej ankimeve në lidhje më vlerësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë ndërsa për masat e tjera ka lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Sikurse u tha dhe më lart, synimi është që masa e sigurimit “*Arrest në burg*” të kërkohet vetëm në raste kur ajo është e përshtatshme në raport me rëndësinë e faktit, dhe kur është absolutisht e domosdoshme.

Një kriter tjetër që merret në konsideratë në këto raste, është dhe fakti që në momentin kur paraqitet kërkesa caktimin e masës së sigurimit, të ekzistojnë prova të konsoliduara në lidhje me fajësinë e personit të dyshuar.

Në rastet, kur janë kushtet e flagrancës dhe nuk janë zhvilluar hetime më parë me mjete të tjera të kërkimit të provës si përgjime, filmime e vëzhgime, zakonisht për veprat penale që lidhen me veprën penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” në **doza të vogla** kemi kërkuar edhe masa sigurimi “*Arrest në burg*” **me afat** deri në administrimin e akteve të ekspertimit veçanërisht ato daktiloskopike, apo sikurse janë prova të tjera si administrimi i akteve të ekspertimit.

## **CËSHTJET E TRANSFERUARA**

Gjatë vitit 2020, janë transferuar gjithësej **11** (njëmbëdhjetë) procedime penale nga të cilat **9** (nëntë) për moskompetencë tokësore, dhe **2** (dy) për moskompetencë lëndore.

Në cështjet që janë transferuar për shkak të moskompetencës tokësore rezulton se për 9 (nëntë) raste të tjera është vendosur kalimi i akteve Zyrës së Prokurorive që kanë patur kompetencës territoriale për nene të tillë si 298, 297 e 143 të K.Penal ndërsa për cështjet e transferuara për shkak te moskompetencës lëndore janë **2** (dy) cështje, në të cilat subjekti i veprës penale ka qenë subjekt

i Prokurorisë së Posacme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar. Në një nga këto raste Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme ka vendosur mospranimin për kompetencë të procedimit penal dhe ridërgimin e akteve në Prokurorinë e Pogardecit. Ky procedim në vijim i është kaluar për kompetencë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korcë.

### **CËSHTJETE PUSHUARA**

Gjatë vitit 2020 janë pushuar gjithësej **133** (njëqind e njëzetë e dy) **procedime penale**, me **20** (njëzetë) persona nën hetim, nga të cilat **104** (katërmëdhjetë) me kërkesë në gjykatë

- **40** (dyzet) procedime për shkak të mungesës së elementeve të veprës penale;
- **40** (dyzet) procedime për **mungese provash** të mjaftueshme;
- **12** (dymbëdhjetë) raste për shkak të **tërheqies së ankimit** nga viktima;
- **41** (dyzet e një) procedime për **shkaqe të tjera penale**, se fakti nuk përbën vepër penale, **shuarje të veprës penale përfektë parashkrimit**, apo dhe raste kur faktet kanë qenë të hetuara më parë

Sikurse rezulton nga tërësia e cështjeve, cështjet e pushuara zënë një volum prej **13 %** të numrit të përgjithshem të çështjeve, nga **10.5 %** që zinin në vitin 2019, dhe **10 %** që këto cështje zinin në vitin 2018.

Në lidhje me procedimet e regjistruara, cështjet e pushuara zënë në total një volum prej **17 %** të numrit total të procedimeve të regjistruara duke përfshirë këtu dhe ato të mbartura. Në lidhje me totalin e procedimeve të përfunduara, këto cështje zënë një volum prej **20 %** të tyre, **cka e bën këtë një tregues mjaft pozitiv, i përafërt me vitin paraardhës (25 % në vitin 2019)**. Në këto shifra, ka ndikuar dhe detyrimi për të kryer hetime të plota, por ajo është **ndikuar edhe nga praktika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe Gjykatës së Apelit Korçë**, sipas të cilës mjafton kryerja e veprimeve hetimore pas referimit të rastit dhe duhet regjistruar procedimi penal. Vec kësaj dhe me ndryshimet në K.Pr.Penale, vihet re një ritje e numrit të procedimeve të regjistruara edhe për shkak të kalimit të afatit 15 ditor brenda të cilët duhet të vendoset, mosfillimi I procedimit penal.

Nga ana jonë **është mbajtur një qëndrim tjetër** në lidhje me interpretimin e neneve 290 dhe 328 të K.Pr.Penale, por kjo tashmë është një praktike e konsoliduar nga Gjykata e Apelit Korçë, dhe kjo duket dhe në qëndrimet e Prokurorisë së Apelit, në mosmbështetjen e apelimeve të prokurorëve ndaj vendimeve të gjykatës që prishin vendimet e mosfillimit të procedimit penal, në disa raste ku nga ana e prokuoreve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, është ushtruar apeli.

Vec kësaj sikurse u tha dhe më parë, kjo lidhet dhe me ndryshimet e fundit të K.Pr.Penale, dhe pas muajit Gusht 2017, kjo praktikë është ndryshuar dhe në organin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Nga çështjet e pushuara vlen të theksohet se asnjë prej personave nën hetim nuk kanë qenë të siguruar me masë sigurimi “*Arrest në burg*”. Në 3 (tre) nga këto raste, fillimisht është kërkuar në gjykatë masa e sigurimit “*Arrest në burg*” me afat, por më pas është operuar me kërkësë për zëvendësimin e masës së sigurimit.

Kjo lidhet me faktin se u është kushtuar rëndësi që në momentet e para të hetimeve, që nga njëra anë të vendoset një masë sigurimi e përshtatshme me rëndësinë e faktit të kryer dhe rrezikshmërinë e autorit, dhe nga ana tjetër të ketë prova të mjaftueshme nga të cilat të rezultojë se mund të ngrihet një akuzë, dhe cështja të dergohet për gjykim.

Këtij synimi i ka shërbyer dhe praktika e diskutimeve të prokurorit dhe drejtuesit në momentin e caktimit të masës së sigurimit.

Po kështu, për një kategori veprash penale, sikurse janë “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*” apo “*Falsifikimi i dokumentave*” parashikuar nga nenet 291 dhe 186/1 I K.Penal, tashmë është një praktikë e konsoliduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe më pas dhe Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, vendosja e masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” për autorët e mundshëm të veprave penale, përvèc kur këta subjekte janë përsëritës, ose shoqërohen me veprime të tjera sikurse mund të jetë dhe “*Kundësrhimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”.

Nga 104 çështjet e dërguara për pushim në gjykatë, është vendosur pranimi i kërkësës së prokurorit për 94 raste dhe 10 çështje është vendosur kthimi i akteve duke u urdhëruar kryerja e veprimeve të tjera hetimore e proceduriale.

Vlen të theksohet se në 10 (katër) rastet që nuk është miratuar kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal nga Gjykata, 3 (tre) kanë patur të beje me veprën penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*” parashikuar nga neni 290 i K.Penal, duke u urdhëruar rieksperimi autoteknik për herë të dytë apo të tretë ; në 2 (dy) vepra penale e “*Shpërdorimit të detyrës*” parashikuar nga neni 248 I K.Penal; në 2 (dy) raste vepra penale “*Prodhim e shitje e narkotikëve*” ; në 1 (një) rast vepra penale “*Falsifikim i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186/1 I K.Penal; në 1 (një) rast vepra penale “*Dhuna në familje*” parashikuar nga neni 130/a/1 I K.Penal dhe në 1 (një ) rast vepra penale “*Përndjekje*” parashikuar nga neni 121/a/1 I K.Penal.

## **CËSHTJE TË PEZULLUARA**

Gjatë vitit 2020 janë pezulluar 72 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) procedime penale, nga 71 (njëqind e tridhjetë e një) në vitin 2019 dhe nga 118 (njëqind e njëzetë e shtatë) në vitin 2018, për arsy se nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve të veprave penale.

Në total këto çështje zënë 9.3 % të numrit të procedimeve penale duke përfshirë këtu dhe ato të mbartura, dhe 11 % të numrit të procedimeve penale të përfunduara. Shumica e këtyre çështjeve

kanë të bëjnë me veprat penale kundër pasurisë dhe veçanërisht me veprën penale të “*Vjedhjes*” apo “*Shkatërrimit të pronës*” parashikuar nga neni 134/1 dhe 150 të K.Penal.

Nga sa rezulton, duke patur parasysh dhe specifikat e rrithit, shtrirjen e tij gjeografike, karakteristikat e territorit, popullsinë e tij, mund të themi se numri i këtyre çështjeve, mbetet relativisht i lartë krahasuar me numrin e përgjithshme të çështjeve.

Në aspektin procedural, vërehet se një pjesë e këtyre ceshtjeve, janë të një natyre artificiale, pasi në mjaft raste, lidhet me sende të humbura, vecanërisht telefona gjatë periudhes së verës.

Po kështu një numër i konsiderueshëm i këtyre çështjeve, kanë të bëjnë me hetimin e veprave penale të “*Vjedhjes*”, të ndodhura veçanërisht gjatë periudhës Qershori-Shtator, kohë në të cilën rritet ndjeshëm numri i pushuesve të ardhur nga rrithet e tjera.

Si natyrë e këtyre edhe në vitin 2020, mund të përmendim vjedhjet sporadike të telefonave, vjedhjet e sendeve të luajtshme ndërkokë që konstatohen raste të rralla të vjedhjes së banesave.

Është e domosdoshme që për zbulimin e autorëve të këtyre veprave penale, që përbëjnë një shqetësim real për komunitetin, të ketë një angazhim më të lartë të strukturave policore, jo vetëm në veprime që do të rrisin zbulueshmërinë por mbi të gjitha në parandalimin e tyre.

### **NDRYSHIMET E KUALIFIKIMIT LIGJOR GJATË HETIMIT**

Gjatë fazës së hetimit paraprak, ndryshimet e kualifikimit ligjor kanë qenë të pakta 7 (shtatë) raste, në 7 (shtatë) çështje, por në asnjë rast personi nuk ka qenë marrë i pandehur, pra nuk ka patur në asnjë rast ndryshim akuze.

Këto raste, kanë patur të bëjnë kryesisht me veprat penale kundër personit dhe vepra penale në lidhje me shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor.

### **ZGJATJA E AFATIT TË HETIMEVE PARAPRAKE**

Gjatë fazës së hetimeve paraprak, është zgjatur afati i hetimit në **115** (njëqind e pesëmbëdhjetë) çështje penale, nga të cilat;

- **85** (tetëdhjetë e pesë) raste deri në **3** (tre) muaj;
- **23** (njëzetë e tre) raste deri në **6** (gjashtë) muaj;
- **7** (shtatë) raste **mbi 6** (gjashtë) muaj;

Si shkaqe të evidentuara të cilat kanë ndikuar në zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake, mund të përmendim, mosadministrimin në kohë të akteve të ekspertimit, apo mosadministrimin në kohë të përgjigjeve të Kompanive të Telefonive Celulare.

Mëgjithatë mund të permendim që këto zgjatje afati, mund të janë bërë dhe për shkaqe të natyres së hetimit, në çështje komplekse, apo dhe si rezultat i neglizhencës në kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGJ apo dhe vetë prokurorët.

Në këtë vit, shkak për zgjatjet e afatit të hetimeve, është bërë vecanërisht ndryshimi i vazhdueshëm i numrit të prokurorëve, dhe lëvizja apo komandimi i tyre, ku në një periudhë gati tre mujore, prokuroria ka funksionuar me dy prokurë ku njëri nga këta ka qenë drejtuesi.

Në vijim mbetet si detyrë, ulja numrit të çështjeve për të cilat zgjaten afatet e hetimit. Kjo synohet të arriet nëpërmjet

- Kontrollit të ushtruar nga ana e prokurorëve, në veprimtarinë hetimore të OPGj;
- Takimeve periodike të drejtuesit me drejtuesit e seksioneve të policisë gjyqësore;
- Rritjen e kontrollit nga ana e drejtuesit mbi veprimtarinë hetimore të prokurorit;

### **PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKE**

Gjatë këtij viti, kemi patur vetëm një rast të regjistrimit nën hetim të emrit të personit juridik për veprën penale “shkatërrim prone” parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe cështja ështe ende në fazën e hetimit.

### **MASAT MJEKËSORE DHE EDUKUESE**

Gjatë vitit 2020, ka patur dy raste kur është kërkuar në gjykatë caktimi i masave së sigurimit personal “shtrim i përkohshëm” parashikuar nga neni 239 I K.Pr.Penale dhe në 2 (dy) raste është kërkuar caktim i masës mjekësore në zbatim të nenit 36 të Kodit Penal.

Diskutim ngelet mënyra se si duhet të procedohet me kërkeshat për caktim mase mjekësore në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal. Nëse duhet të kërkohet caktimi i masës mjekësore njëkohësisht së bashku më kërkeshën për pushimin e procedimit penal apo duhet të kërkohet gjatë hetimeve paraprake si kërkeshë e vecantë dhe pas caktimit të masës mjekësore me vendim gjykatë të kërkohet pushimi i procedimit penal. Ky diskutim rrjedh nga praktika të ndryshme në prokuroritë dhe nga ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale me lifjin nr. /2016 sepse kërkesa për pushimin e procedimit penal është një kërkeshë që shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake ndërsa kërkesa për caktimin e masës mjekësore është një kërkeshë që duhet ti nënshtrohet gjykimit të themelit dhe nuk mund të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake.

Në lidhje me masat edukuese, ndonësë Kodi Penal I Drejtsisë për Të Miturit ka hyrë në fuqi, nuk kemi asnjë rast të kërkimit/caktimit të masës edukuesë për të miturit në konflikt më ligjin. Kjo pasi ende nuk ka një institucion të posacëm për ekzekutimin e masave edukuese.

**Duke përbledhur në total veprimtarinë e prokurorisë në fazën e hetimit paraprak për vitin 2020, rezulton se** janë trajtuar gjithësej **1015 (njëmijë e pesëmbëdhjetë)** materiale kallëzuese duke përfshirë këtu dhe cështjet e mbartuara nga viti 2019.

Nga viti **2019** janë mbartur **267** (dyqind e gjatëdhjetë e shtatë) procedime penale, një numër më i lartë krahasuar me atë të mbartur në vitin 2018 -2017 procedime te mbartuara (70 procedime më shumë).


Gjatë vitit **2020**, janë regjistruar **748** (shtatëqind e dyzet e tetë) materiale kallëzuese, nga **795** (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) materiale kallëzuese të regjistruara në vitin 2019 dhe **834** (tetëqind e tridhejtë e katër) materiale kallëzuese të regjistruara në vitin 2018. Sikurse vihet re, janë trajtuar nga prokuroret, një numër i përafërt cështjes, me rreth **47** (dyzet e shtatë) materiale kallëzuese më pak se në vitin 2019.

Nga totali prej **1015 (njëmijë e pesëmbëdhjetë)** materiale kallëzuese duke përfshirë këtu dhe cështjet e mbartuara nga viti 2019 (267 procedime të mbartura), procedime penale janë regjistruar **771** (shatëqind e shatëdhjetë e një) ndërsa në vitin 2019 kanë qënë të trajtuara **696** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) procedime penale (75 procedime me pak).

Pra në lidhje me procedimet e regjistruara si të tilla **përgjatë vitit 2020**, vlen të theksohet se janë regjistruar **504** (pesëqind e katër) të tillë vetëm përgjatë vitit **2020**, nga **499** (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) procedime të regjistruara në vitin paraardhës **2019**.

Pra sikurse rezulton, gjatë vitit **2020** ka patur një rritje të numrit të procedimeve penale, me **5 (pesë)** procedime penale të regjistruara më shumë se viti **2019**, ndërkohë që edhe numri i procedimeve penale të trajtuara gjatë vitit 2020 duke përfshirë edhe ato të mbarturat nga vitet e kaluara ka qënë më i lartë **771** (shatëqind e shatëdhjetë e një) **nëga 696** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) procedime penale të trajtuara në vitin 2019.

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për **213** (dyqind e trembëdhjetë) materiale kallëzuese nga **323** (treqind e njëset e tre) të tilla në vitin paraardhës viti 2019, dhe **362** (treqind e gjashtëdhjetë ë dy) në vitin **2018**. Pra numri i kallëzimeve për të cilin është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal është ulur dhe nga një vit më pare, rreth 110 (njëqind e dhjetë ) vendime mosfillime më pak.



Nga tërësia e procedimeve penale të regjistruara dhe të mbartura në vitin **2020**, **356** (treqind e pesëdhjetë e gjashtë) prej tyre janë mbartur për në vitin **2021**.

Nga sa rezulton, numri i procedimeve penale të mbartura në vitin **2021**, është më i lartë krahasuar më atë të procedimeve penale të mbartura nga viti **2019** për në vitin **2020**.

Por duke verejtur numrin e përgjithshëm të procedimeve penale të regjistruara në vitin **2020**, rezulton se gjatë vitit **2020** së bashku me dosjet e mbartura nga viti paraardhës (267 procedime të mbartura), janë trajtuar **771** (shatëqind e shatëdhjetë e një) procedime penale ndërsa në vitin 2019 kanë qënë të trajtuara **696** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) procedime penale, 75 procedime me shumë.

Veç kësaj shumica e çështjeve të mbartura janë regjistruar tre mujorin e fundit të vitit **2020**, **ndërkohë** që vlen të përmendet, se në gjashtë muajt e fundit, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, ka patur mungesë stafi, për shkak se deri ne datën 01.07.2020 kanë qënë efektivë në short për shpërndarjen e dosjeve vetëm dy prokurorë.

Ndonëse ekzistojnë dhe shkaqe të tillë, vihet re që ky numër është një numër relativisht i lartë duke patur parasysh numrin e prokurorëve dhe llojin e çështjeve. Mbetet për detyrë që në vitin **2020**, të përfundohen hetimet në një kohë më të arsyeshme me qëllim që të mos mbarten shumë çështje në vitin pasardhës, por dhe të shkurtohen afatet e hetimit.

Në këtë mënyrë mbetet si detyre, kontrolli i vazhdueshëm i prokuroreve në veprimtarinë hetimore të OPGj, por dhe midis vetë prokurorëve nga ana e drejtuesit.

Vec kësaj, kërkohet që të shtohet me një prokuror, dhe organika e kësaj prokurorie, ose të paktën të sigurohet qëndrimi permanent në detyrë i jo më pak se 4 (katër) prokurorëve, duke përfshirë dhe drejtuesin i cili deri më sot, ka përballuar vetë një numer të konsiderueshem cështjesh.

## **VEPRAT PENALE NË FUSHËN E KRIMIT EKONOMIK-FINANCIAR DHE KORRUPSIONIT**

Në lidhje me grup veprat penale të fushës së **Krimtit Ekonomik dhe Financiar**, abuzimit me detyrën si dhe me veprat penale në fushën e **Korrupsionit**, mund të themi se për këtë kategori veprash, procedimet penale janë të pakta.

Kjo vjen si rezultat jo vetëm se kallëzimet, veçanërisht nga qytetarët janë të rralla, por dhe referimet nga policia e shtetit apo dhe institucione të tjera si K.L.SH, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë të pakta.

Kjo mund të lidhet dhe me faktin se në Qytetin e Pogradecit, nuk janë të përqëndruara shumë institucione qëndrore në nivel vendor, pasi shumica e tyre janë të organizuara në rangun e Drejtive Rajonale.

Megjithatë vlen të theksohet se këtë vit, janë regjistruar 11 kallëzime vecanërisht për veprën penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Këtë vit janë regjistruar 2 (dy) procedime penale për veprën penale të “*Pastrimit të produkteve të veprës penale*” parashikuar nga neni 287 i K.Penal dhe 1 (nje) procedim per vepren penale “Mosdekclarim ne kufi te te hollave dhe sendeve me vlere” të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal.

Ndërkokë që për veprën penale të “*Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 259 i K.Penal, **nuk ka referime e si rrjedhojë nuk ka procedime penale të regjistruara**, sepse tashmë kjo vepër penalë ështyё kompetencë lëndore e Prokurorisë së Posacme.

Janë regjistruar 24 (njëzetë e nëntë) kallëzime penale, për veprën penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” parashikuar nga neni 248 i K.Penal, 7 më pak se në vitin 2019. Ndërkokë që për 13 (nëntëmbëdhjetë) prej tyre është vendosur mosfillimi i procedimit penal, **11** (dhjetë) janë regjistruar si procedime penale.

Nga procedimet e regjistruara, duke përfshirë dhe ato të mbartura ( 10 cështje) për **10** (dhjetë) prej tyre, është vendosur pushimi i procedimit penal, **1** (tre) cështje me **3** (shtatë) të pandehur, janë dërguar për gjykim, 1 (një) cështje është transferuar dhe është shpallur moskompetenca tokësore, dhe për të tjerat vazhdojnë hetimet.

## **ZBATIMI I LIGJIT TË DEKRIMINALIZIMIT**

Gjatë vitit 2020, nuk ka patur **asnje** procedime të iniciuara për veprën penale të “*Falsifikimit të vulave, stampave apo formularëve*” parashikuar nga neni 190 i K.Penal, në lidhje me subjektet që kanë plotësuar formularin e deklarimizimit.

## **VENDIME TË SHFUQIZUARA**

Gjatë vitit 2020, nuk ka vendime të shfuqizuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme për shkak të ndryshimit të ligjit.

**Ne vendimet e mosfillimit të procedimeve penale**, vlen të theksohet se vetëm 14 (katërmbëshjetë) prej tyre janë ankimuar në gjykatë.

- për 12 (dymbëdhjetë) është vendosur mospranimi i kërkesës,
- për 2 (dy) raste Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka vendosur prishjen e vendimit duke urdheruar regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve.
- në 2 (dy) raste, është ushtruar apel nga ana e prokurorit, dhe në të dyja rastet, apeli i prokurorit nuk është mbështetur.

**Nga çështjet e pushuara**, rezulton se nuk janë ankimuar në gjykatë nga subjektet e interesuara

### **• CESHTJET E DËRGUARA PËR GJYKIM**

Gjatë vitit 2020, janë dërguar në gjykim 230 (dyqind e tridhjetë) procedime penale me 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) të pandehur, ndërkohë që në vitin 2019 ishin dërguar për gjykim 225 (dyqind e njëzet e pesë) procedime penale me 230 (dyqind e tridhjetë) të pandehur.

Ndër të pandehurit 50 (pesëdhjetë) kanë qenë me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 5 (pesë) të pandehur me masë sigurimi “*Arrest në burg në mungesë*”, 20 (njëzet) me masë sigurimi “*Arrest në shtepi*”, ndërsa pjesa tjetër me masa të ndryshme sigurimi apo dhe në gjendje të lire.

Procedimet penale të dërguara në gjyq zënë një shifër 23 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të hetuara (duke përfshirë këtu dhe çështjet e mbartura nga vitin 2019), **ndërkohë në lidhje me procedimet penale të përfunduara numri i tyre i është 51.6 %**

Procedimet penale me perspektivë dërgimin për në gjykatë, kanë qenë prioritet i punës së prokurorëve. Për këto çështje është treguar kujdes, që të mos ngrihen akuza të pabazuara, cka vërtetohet dhe nga numri i pakët i pafajësive dhe pushimeve të çështjeve në gjykatë 6 (gjashtë) raste pafajsi, nga të cilat 2 (dy) janë raste pafajësie të pjeshme dhe 4 (katër) raste pushimi. Për një rast Gjykata e Apelit Korçë ka prishur vendimin gjyqsor të pushimit ndërsa ankimet e tjera janë ende në fazë gjykimi në Gjykatën e Apelit Korçë.

Nga ana tjetër, për vepra penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës kryesisht, apo me vepra penale kundër pasurisë është mbajtur parasysh që hetimet ndaj autorëve të tyre të cilët janë dërguar më pas në gjykim, të kryheshin në gjendje arresti.

Gjatë vitit 2020, është përfaqësuar organi i prokurorisë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në 20 (dyzete e tre) çështje me të dëmtuar akuzues.

### **III. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorëvë gjatë fazës së gjykimit**

#### **• FAZA E GJYKIMIT TË PROCEDIMEVE PENALE**

Gjatë vitit 2020, janë dërguar në gjykim 230 (dyqind e tridhjetë) procedime penale me 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) të pandehur, ndërkohë që në vitin 2019 ishin dërguar për gjykim 225 (dyqind e njëzet e pesë) procedime penale me 230 (dyqind e tridhjetë) të pandehur dhe në vitin 2018 ishin dërguar 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) procedime me 209 (dyqind e nëntë) të pandehur.

Ndër të pandehurit 57 (pesëdhjetë e shtatë) kanë qenë me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 9 (nëntë) të pandehur me masë sigurimi “*Arrest në burg në mungesë*”, 19 (nëntëmbëdhjetë) me masë sigurimi “*Arrest në shtepi*”, ndërsa pjesa tjetër me masa të ndryshme sigurimi si “garanci pasurore” apo dhe në gjendje të lire.

Në periudhën objekt analize, duke përfshirë dhe procedimet e çuara për gjykim vitet e mëparshme (të mbartura 110 çështje me 110 të pandehur), prokurorët janë paraqitur për të mbrojtur akuzën në gjykatë (gjykime te zhvilluara në shkallë të parë) në 340 (treqind e dyzetë) **procedime** penale, me 365 (treqind e gjashtëdhjetë pesë) të pandehur, nga të cilët 70 (shtatëdhjetë) të pandehur me masën e sigurimit “*Arrest në burg*”.

Është përfunduar gjykimi në 230 (dyqind e tridhjetë) çështje me 240 (dyqind e dyzetë) të pandehur, nga të cilët 50 (pesëdhjetë) të pandehur nën masën e sigurimit “*Arrest në burg*”, dhe janë mbartur

**për vitin 2021, 110** (njëqind e dhjetë) çështje me **115** (njeqind e pesëmbëdhjetë) të pandehur, nga të cilët **20** (njëzet) nën masën e sigurimit “*Arrest në burg*”.

- Në **3 (tre)** çështje me **3 (tre)** të pandehur, është operuar me procedurën e **gjykimit të drejtpërdrejtë**, duke patur parasysh se nuk ka patur nevojë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore;
- Në **166** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) çështje me **174** (njëqind e shatëdhjetë e katër) të pandehur, gjykimi është zhvilluar me procedurën e **gjykimit të shkurtuar**;
- Në **40** (dyzet) çështje me **42** (dyzet e dy) të pandehur, gjykimi është zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm.
  - në **3** (një) nga këto raste, me **3 (tre)** të pandehur gjykimi është zhvilluar **në mungesë** të të pandehurit;
    - Në **16** (gjashtëmbëdhjetë) çështje është operuar më gjykimin me marveshje
    - Në **5** (pesë) çështje është operuar më urdhër penal

Një problematikë e cila vihet re, në lidhje me mosbërjen e kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë, është dhe fakti se që prej muajit Prill të vitit 2014, të arrestuarit apo të ndaluarit, nuk mbahen më gjatë afatit 48 (dyzetë e tetë) orësh në dhomat e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Pogradec, por dërgohen në dhomat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë.

- **GJYKIMIN ME MARRËVESHJE DHE URDHRI PENAL**

Gjatë vitit 2020, janë dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për tu gjykuar me gjykimin e posacëm me marrëveshje, 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështje penale.

Në asnjë rast marrëveshjet nuk janë refuzuar nga gjykata, pra janë pranuar në **11** (njëmbëdhjetë) raste, ndërkohë që për **5** (pesë) raste të tjera vazhdon gjykimi gjatë viti 2021.

Në **1** (një) rast gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorit për shkaqe proceduriale sepse ishin dy të pandehur, nga të cilët për njërin ishte proceduar me marrëveshje ndërsa I pandehuri tjëtër ishtë në mungesë dhe duhej proceduar me ndarjen e cështjes. Pasi kthimit dhe ndarjes së cështjes, gjykata ka vendosur miratimin e marëvëshjes.

Gjatë vitit 2020, janë dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, për tu gjykuar me gjykimin e posacëm me urdhër penal **5** (pesë) çështje penale, të cilat janë miratuar të gjitha nga gjykata.

- **PAFAJËSI DHE PUSHIMI I CËSHTJEVE GJATË GJYKIMIT**

Gjatë këtij viti janë dhënë **6** (gjashtë) pafajësi, nga gjykata për 6 (gjashtë) të pandehur, nga të cilat 2 (dy) të pandehur janë në një cështje.

- Procedimi penal Nr. 351 të vitit 2018, me **2** (dy) të pandehur, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Mashtrimit*” dhe “Moskallzim krimi”, parashikuar nga neni 143/1 e 300 i K.Penal. Pafajsi e pjeshmshme për akuzën e “Moskallzimit të krimit” parashikuar nga neni 300 i K.Penal. Mbi bazën e ankimit të prokurorit, cështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit dhe nuk është pranuar ankimi.
- Procedimi penal Nr.74 i vitit 2018 për 1 (një) të pandehurin për veprën penale të “*Plagosjes së lehtë me dashje*” parashikuar nga neni 89 I K.Penal. Mbi bazën e ankimit të prokurorit, cështja është duke u gjykuar ende nga Gjykata e Apelit Korçë.
- Procedimi penal Nr.300 i vitit 2019, me 2 (dy) të pandehur të akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik*” parashikuar nga neni 236/1 i K.Penal. Nuk është ankimuar nga prokurori i cështjes.
- Procedimi penal Nr.54/4 viti 2019, me 8 (tetë) të pandehur për veprën penale “Trafik i lëndëve narkotike”, te parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal . Pafajsi e pjesshme për një nga të pandehurit dhe nbi bazën e ankimit të prokurorit, cështja është duke u gjykuar ende nga Gjykata e Apelit Korçë.
- Procedimi penal Nr.282 viti 2020, me 1 (një) të pandehur për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, te parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal .Mbi bazën e ankimit të prokurorit, cështja është duke u gjykuar ende nga Gjykata e Apelit Korçë.

Në lidhje me **4** (katër) raste të **pushimit të cështjes** gjatë gjykimit, edhe organi i prokurorisë ka shfaqur mendimin dhe ka qenë dakord me këtë vendimarrje të gjykatës vetëm në 1 (një) rast ndërsa 1 (një) rast ka patur si shkak tërheqien e ankimit nga ana e të pandehurit.

- **NDRYSHIMET E KUALIFIKIMIT LIGJOR NË GJYKATË**

Gjatë këtij viti, ka patur vetëm 1 (një) rast të ndryshimit të kualifikimit ligjor në gjykatë, e cila lidhet me ndryshimin e akuzës nga neni 283/2 i Kodit Penal në nenin 283/1 të Kodit Penal. Kjo cështje është ankimuar nga prokurori dhe ankimi është në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

- **TËRHEQIA E AKTEVE GJATË GJYKIMIT**

Gjatë këtij viti ka patur vetëm 1 (një) rast të tërheqies së akteve e gjatë gjykimit. Ndonëse kjo e drejtë nuk i njihet më prokurorit të çështjes, ai ka kërkuar në gjykatë tërheqien e akuzës dhe gjykata më pas ka vendosur pushimin e çështjes .

- **LLOJET E DËNIMIT TË APLIKUARA**

- në **42** (dyzet e dy) raste, prokuroria ka kërkuar aplikimin e dënimit me **gjobë**, dhe nga gjykata është aplikuar dënimimi me gjobë në **33** (tridhjetë e tre) raste dhe në **5** (pesë) raste është vendosur pafajësia e të pandehurit ndërsa në **4** (katër) raste është vendosur pushimi i cështjes.
- në **147** (njëqind e dyzet e shtatë) raste, është kërkuar nga prokurori dënimini i të pandehurve me burg, dhe gjykata ka dhënë dënimin me burg në **147** (njëqind e dyzet e shtatë) raste.
- nga dënimet me burgim në **62** (gjashtëdhjetë e dy) raste, **prokurori** ka kërkuar nga gjykata pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe nga **gjykata** është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim në **80** (tetëdhjetë) raste;
- nga dënimet me burgim prokurori ka kërkuar në gjykatë në **3** (tre) raste zëvendësimin e saj me punë në interes publik, ndërsa gjykata e ka dhënë atë **5** (pesë) raste;

**LLOJET E DËNIMEVE TË APLIKUARA NË GIYKIMIN ME MARRËVESHJE**

- Duke marrë në konsideratë dhe specifikat që paraqet ky lloj gjykimi i posaçëm, si dhe faktin që ai është një risi në Kodin e Procedurës Penale, mund të themi që per vitin 2020 kemi një rerie te numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me marveshje që zënë një numër gati 7 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të dërguara për gjykim. Në këtë rerie ka ndikuar edhe situata e krijuar nga pandemia e Covid -19 gjatë të cilës për disa muaj ka patur masa kufizuese për ushtrimin e veprimtarisë hetimore dhe në vazhdim edhe pas rifillimit të veprimtarisë hetimore është kufizuar në maksimum kontakti me të pandehurit. Duke qënë se realizimi i marveshjes duhet të kryhet me pjesmarrjen dhe kontaktin e drejtpërdrejtë të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, me qëllim respektimin e masave mbrojtëse kundër Covid-19 është në shumë raste është shhangur kontakti fizik me të pandehurit dhe është zgjedhur të procedohet jo me marveshje.
- Në lidhje me masat e dënimit, që aplikohen në këtë lloj gjykimi, mund të themi se zakonisht të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, tregohen të gadshëm, për

nënshkrimin e një marrëveshje të propozuar nga prokurorët apo të propozuar nga vetë të pandehurit, kur ata "*joshen*" me një alternative të dënimit me burgim, kryesisht pezullimin e dënimit me burgim, dhe vendosjen e të pandehurit në kohë prove.

- Duke u nisur nga këto specifika, mund të themi se ky rit gjykimi, është përdorur në çështje të tilla ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka vendosur një lloj standartizimi të llojit dhe masës së dënimit, apo mënyrës së ekzekutimit të tij, ku mund të përmendim veprat penale të "*Drejtimit të automjeteve në mërnjre të parregullt*" apo "*Falsifikimit të dokumentave*" të identifikimit, apo "*Ndërtimi i paligjshëm*" apo parashikuar nga nenet 291, 186/1 dhe 199/a/l/2 të K.Penal.
- Po kështu me marrëveshje, ka patur raste që të pandehurit janë treguar të gadshëm për negocimin dhe arritjen e saj, në rastet kur ata kanë qenë nën masën e sigurimit "*Arrest në shtëpi*" parashikuar nga neni 237 I K.Pr.Penale, apo kur ka qenë nën masën e sigurimit "*Arrest në burg*" dhe masa e dënimit e dakortësuar, ka qenë e përafërt me dënimin e vuajtur, apo disa ditë më shumë ndonëse këto raste janë të rralla.
- Rezulton se në asnjë rast gjykata nuk ka refuzuar marrëveshjet por janë miratuar deri tanë 11 (njëmbëdhjetë) raste, ndërkohë që për 5 (pesë) raste të tjera vazhdon gjykimi gjatë viti 2021.
- Në 1 (një) rast gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorit për shkaqe proceduriale sepse ishin dy të pandehur, nga të cilët për njërin ishte proceduar me marrëveshje ndërsa I pandehuri tjëtër ishtë në mungesë dhe duhej proceduar me ndarjen e cështjes. Pasi kthimit dhe ndarjes së cështjes, gjykata ka vendosur miratimin e marëvëshjes.
- Në 15 (pesëmbëdhjetë) raste, lloji i dënimit të aplikuar ka qenë dënim i kusht, apo është pezulluar dënim i burgim, duke u vendosur i pandehuri në prove
- Në 2 (dy) raste është zëvendësuar dënim i burgim, me kryerjen e një punë në interes public, sipas nenit 63 të K.Penal;

### **DËNIME PLOTËSUESE**

Është kërkuar në 3 (tre) raste dënimin plotësues të "*Ndalimit për të drejtuar automjete*" parashikuar nga neni 37 I K.Penal dhe gjykata e ka aplikuar këtë dënim në 3 (tre) raste.

- **APELIME E REKURSE**

Gjatë vitit 2020, është ushtruar e drejta e ankimit në apel kundër vendimit përfundimtar të gjykatës, në 29 (njëzet e nëntë) raste, nga të cilat:

- **14** (katërmëdhjetë) raste për masa sigurimi;
- **2** (dy) raste për vendimet e gjykatës për seancat paraprake
- **4** (katër) raste për vendim pafajësie,
- **3** (tre) raste vendim pushimi të gjykimit
- **1** (një) rast për ndryshim kualifikimi dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.
- **5** (gjashtë) apele kanë patur të bëjnë me llojin dhe masën e dënimit të dhënë nga gjykata, si dhe menyrën e ekzekutimit të dënimit;

### **Nga Gjykata e Apelit Korçë**

- janë pranuar **5** (pesë) apele për masat e sigurimit, ndërkohë që nuk janë pranuar 9 (nëntë) apele;
  - nuk janë pranuar 3 (tre) apele për llojin dhe masën e dënimit, ndërkohë që janë ende në shqyrtim 2 (dy) apelet e tjera
  - nuk është pranuar **1** (një) rast pafajësie, ndërkohë që janë ende në shqyrtim 3 (tre) apelet e tjera
    - është pranuar 1 (një) apel për vendimet e gjykatës për seancat paraprake dhe nuk janë pranuar 1 (një) apel për vendimin e gjykatës për seancat paraprake
  - është pranuar **1** (një) apel për vendim pushimi të gjykimit, ndërkohë që janë ende në shqyrtim 2 (dy) apelet e tjera
  - **1** (një) apel për ndryshim kualifikimi dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal është ende në shqyrtim.

### **Nuk është ushtruar gjatë këtij viti e drejta e apelimit kundërshtues.**

Sikurse rezulton, e drejta e apelit ndaj vendimeve të gjykatës është ushtruar në fare pak raste, rastet e pafajësisë dhe pushimit të cështjes, si dhe në pak raste dhe kryesisht ka të bëjë me llojin dhe masën e dënimit, dhe me mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kjo pasi nga ana jonë i është kushtuar rëndësi fazës së hetimit paraprak, marrjes dhe administrimit të provave, si dhe mjaftueshmërisë së tyre për të provuar fajësinë e të pandehurve.

Po kështu, vendimet e gjykatës në lidhje me llojin dhe masat e dënimit nuk kanë qenë dukshëm të ndryshme nga kërkesat e prokurorit, çka tregon për një nivel të lartë profesional të prokuroreve, në procesin e mbledhjes dhe administrimit të provave gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe çmuarjes së tyre gjatë gjykimit, duke marrë në konsideratë dhe duke qenë të kujdeshëm, në përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të autorit, kushteve dhe rrëthanave familjare e shoqërore të të pandehurit, si dhe përcaktimin në tërësi të të gjitha rrëthanave që i shërbejnë individualizimit të dënimeve.

- **KOMPENSIMET PËR BURGIM TË PADREJTË**

Gjatë këtij viti, ka patur 6 (gjashte) kërkesa për kompensim për burgim të padrejtë, në lidhje me procedim penal të vitit 2017-2019, kërkesa nga të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka pranuar 4 (katër) kërkesa dhe ka rrëzuar 2(dy) kërkesa.

Në pesë nga këto raste nga ana jonë, janë dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, parashtresat duke dhënë dhe qëndrimin e organit të prokurorisë në lidhje me këto kërkesa, dhe në disa raste ato janë marrë në konsideratë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, vecanërisht në lidhje me masën e dëmshpërbimit.

- **TE DHENA PËR CESHTJET ME TE MITUR**

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar 3 (tre) çështje me të mitur në konflikt me ligjin të gjinisë mashkull dhe 6 (gjashte) çështje me të mitur viktima.

Nga 3 (tre) të pandehurit e mitur në konflikt me ligjin asnjë prej tyre nuk është ndjekur me masën e sigurimit arrest me burg, por 1 (një) është ndjekur me masën e sigurimi "garanci pasurore"; 1 (një) me masën e sigurimit "detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore" dhe 1(një) pa masë sigurimi personale.

Afat i hetimit të çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin ka qënë : 1 (një) është hetuar brenda afatit dy muaj dhe 2 (dy) çështje janë hetuar brenda afatit tre muaj.

Në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin rezulton se 1 (një) çështje është pushuar dhe 2 (dy) çështje janë dërguar për gjykim.

Vetëm për 1 (një) çështje është zbatuar masa e shmangies dhe është aplikuar "Paralajmërim me shkrim"; për 2 (dy) çështje është kërkuar alternativa e dënimit me burgim - nen 59 i K.Penal .

#### **IV.Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore**

Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Pogradec, për periudhen kohore Janar-Dhjetor te vitit **2020** ka nxjerre **254** (dyqind e pesëdhjetë e katër) urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale, nga **386** (treqind e tetëdhjetë e gjashtë) urdhra per ekzekutimin e vendimeve penale në vitin 2019.

Për ekzekutimin e dënimive **me burgim**, janë nxjerrë **97 (nëntëdhjetë e shtatë)** nga **118** (njëqind e tetëmbëdhjetë) të tilla në vitin 2019 dhe **503** (pesëqind e tre) të tilla në vitin 2018.

Për dënimet me burgim janë nxjerrë **85** (tetëdhjetë e pesë) urdhra për ekzekutimin e dënimive alternative, nga **80** (tetëdhjetë) të tilla të nxjerra në vitin 2019 dhe 128 (njëqind e njëzet e tetë ) të tilla të nxjerra në vitin 2018.

Per ekzekutimin e vendimeve penale me gjobë, janë nxjerrë **154** (njëqind e pesëdhjetë e katër) nga **184** (njëqind e tetëdhjetë e katër) urdhëra të nxjera në vitin 2019, dhe **190** (njëqind e nëntëdhjetë) të tilla në vitin 2018.

Janë nxjerrë **3** (njëzetë) urdhëra për ekzekutimin e dënimive plotësuese, nga **4** (katër) të tilla në vitin 2019 dhe **8** (tetë) urdhëra të tilla për vitin 2018.

Deri ne kete moment jane ekzekutuar 92 (nëntëdhjetë e dy) urdhra, nga te cilat **88** (tetëdhjetë e tetë) urdhra i perkasin vendimeve penale me burgim,nga të cilat **85** (tetëdhjetë e pesë) urdhra dënimive alternative ; **2** (dy) urdhra i perkasin vendimeve penale me gjobe dhe **3** (tre) urdhra per ekzekutimin e denimeve plotesuese.

Jane ende te paekzekutuara **169** (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) urdhra, nga te cilat **9** (nëntë) urdhra i përkasin vendimet qe permajne dëнимi penale me burgim, **152** (njëqind e pesëdhjetë e dy) urdhra per vendimet që përbajnjë denime penale me gjobe.

Kjo pasi dhe për mënyrën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, të pandehurve ju lihet një afat kohor për pagesën e saj.

Per vitin 2020 jane paraqitur ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec **4** (katër) kërkesa, për fazën e ekzekutimit të dënimive penale.

Nga këto kërkesa **2** (dy) kërkesa për revokimin e vendimit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, **2** (dy) kërkesa për zgjatjen e afatit të vënies në provë.

#### **V.Të dhëna mbi mardhëniet juridikSIONALE me autoritetet e huaja**

Në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, edhe gjatë këtij viti ka vijuar të plotësohen

me korrektesë dhe në një kohë mjaft të shkurtër, detyrimet në fushën e Marrëdhënieve Juridksionale me Autoritetet Gjyqësore të Huaja, si ekstradimet, letërporosite, ndonëse kjo zyrë i ka të pakta.

Në një sërë çështjesh janë dërguar **letërporosi për jashtë shtetit**, duke kërkuar nga autoritetet gjyqësore të huaja ekzekutimin e 7 (shtatë) letërporosive. Vlen të theksohet se në të gjitha rastet letërporosive ju është dhënë rrugë nga Ministria e Drejtësisë.

Janë ekzekutuar **10** (dhjete) **letërporosi nga jashtë shtetit**, nga **të cilat 6** (gjashtë) kanë patur si objekt njoftimet e personave, shtetas shqiptarë zakonisht të pandehur në gjykatat e vendeve të tjera, ndërkohë që janë bërë kërkesa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec për 4 (katër) raste, ku **3** (tre) janë **pranuar nga gjykata**, dhe për **1** (një) rast vazhdon gjykimi.

Janë bërë 4 (katër) kërkesa drejtuar gjykatës për lejimin e ekstradimit të shtetasve të huaj, kërkesa që janë pranuar nga gjykata.

Nuk ka patur raste kur të jetë kërkuar informacion nga Autoritetet Gjyqësore të Huaja për ekstradim nga jashtë të personave të denuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Gjatë vitit 2020, është bërë shpallje në kërkim ndërkombëtar i **3** (tre) shtetasve shqiptar, nga të cilët dy të dënuar me vendim penal të formës së prerë ndërsa 1(një) me masë sigurimi “arrest në burg”.

## **VI. NGARKESA E PUNËS SIPAS PROKURORËVE DHE OPGJ**

### **1. Drejtuesja e Prokurorisë **Dorina Bejko**,**

- Ka hetuar gjithësesj **272** (dyqind e shtatëdhjetë e dy) procedime penale
- **88** (tetëdhjetë e tëtë) procedime me **85** (tetëdhjetë e pesë) të pandehur janë dërguar **në gjykim**
- **50** (pesëdhjetë) procedime janë pushuar;
- **24** (njëzet e katër) procedime i ka **pezulluar**;
- **2 (dy)** procedime janë **transferuar**;
- **54** (pesëdhjetë e katër) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal;
- **54** (pesëdhjetë e katër) procedime penale, **janë mbartur** për në vitin 2021.

### **2. Prokurori **Shkëlqim Kokona**, ka trajtuar gjithësaj, **437** (katërqind e tridhjetë e shtatë) procedime e materiale kallëzuese. Nga këto procedime:**

- 105 (njëqind e pesë) procedime penale janë dërguar për **gjykim** me 120 (njëqind e njëzet) të pandehur;
  - 51 (pesëdhjetë e një) procedime janë **pushuar**;
  - 39 (tridhjetë e nëntë) procedime janë **pezulluar**;
  - 6 (gjashtë) procedime janë **transferuar** për në **prokurori** të tjera;
  - 65 (gjashtëdhjetë e pesë) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal;
  - 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) procedime penale **janë mbartur** për në vitin 2021;
3. Prokurori **Gjergji Ceka**, i cili ka punuar pranë kësaj prokurorie prej datës 01.07.2020 ka trajtuar gjithësej, 207 (dyqind e shtatë) procedime e materiale kallëzuese. Nga këto procedime
- 24 (njëzetë e katër) procedime penale janë dërguar për **gjykim** me 30 (tridhjetë) të pandehur;
  - 8 (tetë) procedime janë **pushuar**;
  - 1 (një) procedime janë **pezulluar**;
  - 4 (katër) procedime janë **transferuar** për në **prokurori** të tjera;
  - 70 (shtatëdhjetë) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal;
  - 100 (njëqind) procedime penale **janë mbartur** për në vitin 2021;
4. Prokurori **Gazmend Frengu**, i cili ka punuar pranë kësaj prokurorie prej datës 15.10.2020 ka trajtuar gjithësej, 48 ( dyzetë e tetë) procedime e materiale kallëzuese. Nga këto procedime
- 2 (dy) procedime penale janë dërguar për **gjykim** me 2 (dy) të pandehur;
  - 1 (një) procedime është **pushuar**;
  - 12 (dymbëdhjetë) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal;
  - 33 (tridhjetë e tre) procedime penale **janë mbartur** për në vitin 2021;
5. Prokurori **Erion Pustina**, i cili në datën 11.02.2020 është larguar nga detyra e prokurorit me dorëheqja ka trajtuar gjithësej 13 (trembëdhjetë) procedime e materiale kallëzuese. Nga këto procedime
- 5 (pesë) procedime me 5 (pesë) të pandehur i ka dërguar për gjykim;
  - 6 (gjashtë) cështje janë **pushuar**;

- 1 (një) çështje është **pezulluar**;
  - 1 (një) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal ;
6. Prokurori **Sotir Kllapi**, i cili ka punuar pranë kësaj prokurorie deri në datën 21.05.2020, ka përfunduar trajtuar **gjithësej 38** (tridhjetë e tetë) procedime e materiale kallëzuese. Nga këto procedime
- 6 (gjashtë) çështje me 11 (njëmbëdhjetë) të pandehur i ka dërguar për **gjykim**;
  - 17 (shtatëmbëdhjetë) çështje janë **pushuar**;
  - 4 (katër) çështje janë **pezulluar**;
  - 11 (njëmbëdhjetë) materiale kallëzuese është vendosur **mosfillimi** i procedimit penal ;

#### **NGARKESA E PUNËS SIPAS OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE**

1. Oficeri i Policisë Gjyqësore **Besmir Tafa**, përgjatë vitit 2020 ka hetuar gjithësej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) procedime e materiale kallëzuese, nga të cilat ka përfunduar 45 (dyzet e pesë) prej tyre, ndërsa 20 (njëzet) i ka në hetim.
2. Oficeri i Policisë Gjyqësore **Shiqiri Manjani**, përgjatë vitit 2020 ka hetuar gjithësej 41 (dizete e një) procedime e materiale kallëzuese, nga të cilat ka përfunduar 14 (katërbëdhjetë) prej tyre, ndërsa 27 (njëzet e shtatë) i ka në hetim.

#### **VII. PERSONELI ADMINISTRATIV**

Gjatë vitit 2020, personeli administrativ i kësaj zyre, ka kryer me korrektesë detyrën e vet, duke qenë një mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në ushtrimin e detyrave të tyre.

Personeli administrativ, i kësaj zyre ka përballuar një ngarkesë të konsiderueshme pune, në mbajtjen e arkiv-protokollit, zhvillimit të procedurave të prokurimit, administrimin e buxhetit të prokurorisë, lidhjen e dosjeve, dhe arkivimin e tvre.

Në lidhje me nevojat për burime njerëzore, referuar strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Pogradec dhe duke vlerësuar gjëndjen/nevojat reale të institucionit, duke

patur parasysh edhe zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr.10 datë 17 Korrik 2020 për hetimin e grupveprave penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, cmoj se është e nevojshme plotësimi i organikës edhe me një oficer tjetër duke qënë se në Zyrën e Prokurorisë Pogradec janë vetëm dy oficerë të policisë gjyqsore. Theksoj se nevoja për të patur edhe një oficer tjetër të policisë është emergjente duke patur në vëmendje faktin që njëri nga oficerët Z.Shiqiri Manjani rezulton të jetë fitues në provimin e pranimit të Shkollës së Magjistraturës për këtë vit dhe vendi i tij do të rezultojë vakant pas dorëheqjes së tij. Po kështu duke patur parasysh faktin se në Prokurorinë Pogradec ka vetëm një kryesekretare që është njëkohësisht edhe financierja e Zyres dhe vetëm një sekretare për katër prokurorë , cmoj si të nevojshme shtimin e numrit të sekretareve duke qënë se as Drejtuesi nuk ka një sekretare por të gjitha detyrat e Kryesekretares dhe sekretares i mbulon kryesisht vetëm Kryesekretarja ndërsa sekretarja tjetër kryen detyrat për përgatitjen e dosjeve hetimore/gjyqsore apo detyra të tjera administrative.

Vlen të theksohet se personeli administrativ, kryen një sjellje korakte me qytatret duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe ofrimin e një shërbimi eficënt ndaj tyre.

Po kështu gjatë vitit 2020, është vënë në përdorim thuajse me kapacitet të plotë Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve CAMS, veçanërisht në lidhje me raportimin e regjistrimit dhe përfundimit të cdo materiali kallëzues dhe procedimi penal. Po kështu janë marrë masa për zbatimin e Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Ato jo vetëm ju janë bërë me dije të gjithë prokurorëve, por pasi ata janë njojur janë diskutuar dhe në mbledhjet periodike të stafit të prokurorisë.

## **VIII. PRIORITETET PËR VITIN 2021**

Gjatë vitit 2021, duke patur parasysh dhe analizimin në tërësi të elementeve dhe problematikave të sipërcituara, prioritetet tona kryesore për të ardhmen do të janë:

- Rritja e cilësisë së hetimit, si dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim;
- Rritja e cilësisë së akteve proceduriale nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore pranë prokurorisë;
- Forcimi i pavarsisë së prokurorëve, gjatë hetimit të çështjeve dhe përfaqësimit të organit të prokurorisë para gjykatës; përfundimi në një afat sa më të shkurtër kohor i procedimeve penale të mbartura;
- Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të hetimeve që lidhet me veprat penale në fushën e krimit ekonomik-financiar, dhe ngjarjet e rënda;

- Venia në funksionim të mëtejshëm të sistemit CAMS duke u raportuar të gjitha veprimet hetimore dhe vendimarrjet përkatëse, si dhe kërkesat drejtuar gjykatës;
- Konsolidimi dhe forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me strukturat e policisë gjyqësore;
- Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit ndaj veprimtarisë së policisë gjyqësore;
- Përmiresimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit të punës brenda organit;
- Ruajtja e figurës së pastër etiko-morale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe respektimi i normave të etikës prej tyre; bashkëpunimi me organet e rivlerësimit kalimtar dhe me Prokurorinë e Përgjithshme, për një eficencë më të madhe të procesit;
- Në mënyrë të vecantë kemi diskutuar dhe dakortësuar me trupën e prokurorëve/oficerëve për ti dhënë prioritet marrjes së masave të tillë si: zgjerimi/thellimi/rritja e efikasitetit në hetimin e elementeve të formave të vecanta të bashkëpunimit me qëllim verifikimin e kompetencës lëndore dhe kalimin më tej për kompetencë në Prokurorinë e Posacme të cështjeve që lidhen me grupveprat penale të krimít të organizuar apo korruptionit; rritja e përdorimit të hetimit proaktiv dhe metodave speciale të hetimit të rëndësishme për krijimin/grumbullimin e provave në hetimin e cështjeve penale; rritja e numrit të hetimeve paralele krahas hetimeve për veprën penale kryesore që gjeneron të ardhura nga veprimtaria kriminale; rritja e numrit të hetimeve pasurore në zbatim të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar, të ndjekura me rritjen e kërkesave për sekuestrim/konfiskim të aseteve produkte të veprave penale; zhvillimi i takimeve të përbashkëta me agjensitë e tjera ligjzbatusetë përfshira në hetimin e grupveprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit etj.

Me qëllim arritjen e objektivave të kësaj prokurorie, kërkojmë ndihmen e Prokurorisë të Përgjithshme për plotësimin e stafit, i cili gjatë pesë viteve ka qenë i cunguar dhe prokurorët kanë punuar me periudha të shkurtra.

### DREJTUESE E PROKURORISË

